

KALLARATI



Ec ngado, Kallaratin mos e harro!

ORGAN PERIODIK I SHOQATËS K / A "KALLARATI"
Viti i 18-të i botimit, nr. 107, Prill 2022, Çmimi 50 L
www.kallarati.com; E-mail: gazetakallarati@yahoo.it
Kryeredaktor: Seit Jonuzaj

Botim special, kushtuar jetës dhe aktivitetit artistik të këngëtarit kallaratas, HYSO BALIL XHAFERAJ



HYSO XHAFERAJ,
Bilbili që theu qelqet e qiellit me tingujt e zërit të tij
Përgatiti për gazetën: **Besnik GJONBRATAJ**

(Përmbledhje komentesh, vlerësimesh dhe krijimesh, bërë nga miq, shok, koleg, të afërm, personalitete të artit, kulturës e muzikës shqiptare, për jetën, aktivitetin artistik e shoqëror dhe kontributin në interpretimin e veçantë e me mjeshtri të këngës labe dhe jo vetëm, të birit të Kallaratis, "Bilbilit të Labërisë", Hyso Balil Xhaferaj, ndarë para kohe nga jeta)

NJOFTIM I SHOQATËS KALLARATI "NDAHET NGA JETA HYSO BALIL XHAFERAJ, BILBILI I LABËRISË, KËNGËTARI VIRTUOZ I ANSAMBLIT KOMBËTAR TË KËNGËVE DHE VALLEVE POPULLORE"



Më 27 shkurt 2022, pushoi së rrahuri zemra e birit të Kallaratis, këngëtarit të dëgjuar të Ansambllit Shtetëror të Këngëve dhe Valleve Popullore, bilbilit të këngës labe, Hyso Xhaferaj.

Hysua u lind në Kallarati të Vlorës më 20 tetor 1966, në një familje me ndjenja të theksuara patriotike e lirisdashëse, në familjen Xhaferaj nga prindërit Balil e Fari Xhaferaj. Pasi mbaroi shkollën 8-vjeçare në vendlindje dhe atë të mesme në Brataj, Hysua për disa vite punoi si ushtarak në strukturat e Policisë së Shtetit dhe më vonë jetën ia kushtoi këngës labe.

Kur përmendim emrin Hyso Balili (Xhaferaj), të gjithëve na shkon mendja tek luftëtari i 1914-ës, i cili së bashku me disa bashkëfshatarë të tij dha jetën për mbrojtjen e trojeve të Kallaratis nga sulmet e antardëve grekë. Por një tjetër person po me këtë emër, një stërnip i tij, u shfaq vitet e fundit me plot dinjitet, por me një ndryshim, këtë radhë **jo me forcën e pushkës, por me zërin e tij pushkë**, të veçantë e kumbues, të marrësit,

kthyesit e hedhësit të këngës labe, i cili nëpërmjet saj kërkoi të bëjë emër.

Faqe 2 - 6

Z. HYSO XHAFERAJ,
PERSONALITET I SHQUAR I LABËRISË



Në një atmosferë dhimbjeje e krenarie njëherazi, në përkujtimoren e të 40-tave të Hyso Xhaferaj, në kryeqytet u zhvillua një aktivitet dinjitoz, i programuar si pak të tjerë deri më sot. Nismëtar dhe sponsor i këtij takimi, ishte burri

fisnik nga Fushëbardha Nexhip Onjea.

... "Hyso Xhaferajla boshllëk të madh e të pazëvendësueshëm dot, për mijëra njerëz, në të gjithë trojet shqiptare. ...

Faqe 12

VLERËSIME E KRIJIME LETRARE KUSHTUAR FIGURËS ARTISTIKE TË HYSO XHAFERAJ PËR NDAJEN E PARAKOHSHME NGA JETA

KOMENTE TË SHUMTA, VLERËSIME PAFUND PËR FIGURËN E HYSOS NGA FAMILJARËT, TË AFËRMIT, MIQËT E SHOKËT E TIJ TË SHUMTË, BASHKËFSHATARËT DHE KOLEGËT E PUNËS DHE ARTISTËT NË PËRGJITHËSI. KJO TREGON PËR SHPIRTIN E MADH NJERËZOR DHE ARTISTIK TË KËTJË NJERIU TË PAARRITSHËM ME ZËRIN E TIJ TË VEÇANTË E TË BUKUR. ËSHTË E PAMUNDUR T'Ë BOTOSH TË GJITHA, POR NJË PËRZGJEDHJE TË TYRE, MUND TI LEXONI MË POSHTË.

Faqe 7 - 12

NEXHIP ONJEA, POET



PSE U NXITOVE?!!!

Bilbilat heshtën një çast, pushuan këngën në pyje, dolën nga foletë jashtë, një shok përcollën në yje. ***

AJO KËNGË QË S'U KËNDUA, NGA EVGJENI JONUZAJ



Nga këngëtarja kallaratase, Evgjëni Jonuzaj, dedikuar me dhimbje e lot, bashkëfshatarit, bashkëmohatarit, kolegut të saj, Hyso XHAFERAJ.

RAPSODI, MUHAMET TARTARI "MJESHTRË I MADH"

Homazh për Hyso Xhaferaj



Ç'u këput një këmbë mali... vajtonte aq bukur dikur Zeqo Hoxha. Kjo baladë humbjeje dhe dhimbjeje, ishte e madhe dhe e rëndë sa Bogonica mbi Kallarati.



FESTIME VESHAJ (XHAFERAJ),
motra duke vajtuar për vëllanë me ligje.

U prehsh ne paqe bilbili i motrës

ZËRI QIELLOR I HYSO XHAFERAJT, NGA GAZETARI ALEKSANDËR ÇIPA



Në fakt ai është zëri njerëzor që shpërbën distancat dhe dimensionet e hapësirës. Versioni më autentik i "Enigmës" shqiptare. Zëri i filltë i Hysos është i vetmi, ndoshta si i askujt tjetër që të shkakton si ndiesi dhe perceptim, me çdo kordë dhe tingull të tij, asosacionin e përkryer

të hapësirës dhe tejhapësirës. Ndiqeni në këtë interpretim përbashkues me virtuozen Irini Qirjako dhe pasueshëm me divën Aurela Gaçe, se çfarë magjie përfaqëson ky zë. Hyso Xhaferaj është (them është, sepse ai gjendet në amëshim, por zëri ka mbetur për një udhëtim të pakohë mes jetës njerëzore), një interpret profesionist i tingujve dhe semantikës tingullore.



HYSO XHAFERAJ,

Bilbili që theu qelqet e qiellit me tingujt e zërit të tij

Përgatiti për gazetën: **Besnik GJONBRATAJ**

(Përmbledhje komentesh, vlerësimesh dhe krijimesh, bërë nga miq, shok, koleg, të afërm, personalitete të artit, kulturës e muzikës shqiptare, për jetën, aktivitetin artistik e shoqëror dhe kontributin në interpretimin e veçantë e me mjeshtri të këngës labe dhe jo vetëm, të birit të Kallaratis, "Bilbilit të Labërisë", Hyso Balil Xhaferaj, ndarë para kohe nga jeta)

NJOFTIM I SHOQATËS KALLARATI "NDAHET NGA JETA HYSO BALIL XHAFERAJ, BILBILI I LABËRISË, KËNGËTARI VIRTUOZ I ANSAMBLIT KOMBËTAR TË KËNGËVE DHE VALLEVE POPULLORE"



Më 27 shkurt 2022, pushoi së rrahuri zemra e birit të Kallaratis, këngëtarit të dëgjuar të Ansambilit Shtetëror të Këngëve dhe Valleve Popullore, bilbilit të këngës labe, Hyso Xhaferaj.

Hysua u lind në Kallarati të Vlorës më 20 tetor 1966, në një familje me ndjenja të theksuara patriotike e liridashëse, në familjen Xhaferaj nga prindërit Balil e Fari Xhaferaj. Pasi mbaroi shkollën 8-vjeçare në vendlindje dhe atë të mesme në Brataj, Hysua për disa vite punoi si ushtarak në strukturat e Policisë së Shtetit dhe më vonë jetën ia kushtoi këngës labe.

Kur përmendim emrin Hyso Balili (Xhaferaj), të gjithëve na shkon mendja tek luftëtari i 1914-ës, i cili së bashku

me disa bashkëshpatarë të tij dha jetën për mbrojtjen e trojeve të Kallaratis nga sulmet e antardëve grekë. Por një tjetër person po me këtë emër, një stërnip i tij, u shfaq vitet e fundit me plot dinjitet, por me një ndryshim, këtë radhë **jo me forcën e pushkës, por me zërin e tij pushkë**, të veçantë e kumbues, të marrësit, kthyesit e hedhësit të këngës labe, i cili nëpërmjet saj kërkoi të bëjë emër.

I rritur në një ambient këngëdashës dhe i pasionuar pas këngës së bukur labe, shumë shpejt Hysua u bë një nga këngëtarët më të mirë e kryesorë të këngës labe kallaratare. Pas shumë vitesh të kënduarit labçe në dasma, sebesesh, festash të Kallaratis e deri në festivale folklorike lokale e kombëtare, ku mund të themi se u poq, me punë e përkushtim arrin të bëhet pjesëtar i një ansambli mjaft të njohur, siç është Ansambli Shtetëror i Këngëve dhe Valleve Popullore, arriti të këndojë e të kontribuojë në këtë ansambël me zërin e tij përkrah artistëve të mëdhenj si: Irini Qirjakos e Hysni Zelës duke marrë pjesë në shumë koncerte brenda e jashtë vendit.

Hysua ishte një shok, vëlla, mik, një prind i shkëlqyer, i dashur e i qeshur me të gjithë. Hysua e donte shumë vendlindjen, Kallaratin, Vlorën e Labërinë. Hysua ishte një patriot i flaktë i çështjes kombëtare, i cili dashurinë për atdheun e shfaqte nëpërmjet këngës labe me të cilën u dashurua përjetësisht.



Hysua u nda nga jeta në një moshë të re, në një kohë kur kishte ende ëndrra për jetën dhe këngën, në një kohë që familja kishte shumë nevojë, por kishte nevojë edhe vetë kënga labe për zërin e tij të veçantë. Me gjithë kujdesin shëndetësor të familjes, edhe pse vetë Hysua ishte tepër optimist, ai nuk mundi të jetojë, se sëmundja u tregua më e fortë, duke e ndarë fizikisht nga familja, shoqëria dhe të gjithë ne.

Hysua sa që gjallë u dashurua me këngën polifonike labe, duke kënduar me Irini Qirjakon

e Hysni Zelën në Ansamblin e Këngëve dhe Valleve Popullore, me grupin "Buronjat Labe", "Antea", "Zadeja" e grupe të tjera së bashku me këngëtarët: Nazif Çela, Mehmet Visha, Trifon Golemi, Sotir Ballo, Velo Çela, Andon Pango, Paro Ziflaj, Golig Jaupi, Neil Ruci, etj, por edhe me zhanre të tjera të muzikës së lehtë me West Side Family, me Aurela Gaçen, etj, duke u bërë shumë i dashur për publikun. Hysua u nda fizikisht nga familja, të afërmit, miqtë e shokët, shoqëria dhe komuniteti i artistëve shqiptarë, por ai do të mbetet i gjallë, sa të rrojë vetë kënga labe, pas së cilës ishte dashuruar përjetësisht.



Kryesia e Shoqatës "Kallarati", u shpreh familjes, të afërme, të atit Bililit, vëllait Bakos, motrave Dafinës dhe Festimes, bashkëshortes Meritës dy djemve të tij Alvaros dhe Fatjonit, dhe gjithë fisit Xhaferaj, ngushëllimet më të thella e të singjerta.

Qoftë i paharruar emri, kujtimi dhe aktiviteti i Tij"U prehtë paqe pranë nënës së Tij, Farisë"



IKËN ZËRI I RRALLË I ANSAMBLIT TË SHTETIT DHE I KËNGËS SHUMËZËRËSHE LABE, HYSO XHAFERAJ. LAMTUMIRË, ARTIST I SHQUAR!

Fjala e mbajtur në Ceremoninë e përcjelljes së tij, më 28 Shkurt 2022, nga Pano HALLKO

I dashur dhe i nderuar Burri Fisnik Balil Xhaferaj!
Të nderuar dhe të dashur bashkëshorte Merita dhe djem të Hyso

Xhaferaj!

Fort të dashur vëllai i tij Bako dhe motrat e tij, Dafina e Festime, Të nderuar pjesëmarrës në këtë ceremoni të përmortshme!
Prej 30 orësh, në të gjitha rrjetet sociale të vendit tonë, në postimet e mijëra njerëzve në botën e Artit dhe të kulturës, mbizotëron një pyetje: **-PSE?!?**

Kjo pyetje, e thjeshtë në dukje por torturose për shpirtat njerëzorë, do vazhdojë të na torturojë për një kohë të gjatë, shumë të gjatë.

Sepse sot përcjellim një burrë, i cili do duhej të përcillte shumë prej nesh që jemi këtu sot. Përcjellim Artistin e lindur dhe të kultivuar, një burrë me personalitet të veçantë, Hyso Balil Xhaferaj.



Hysua u lind në Kallarati të Vlorës më 20 tetor 1966, në familjen emërmirë të Xhaferajve, Biri i prindërve fisnikë, Balil dhe Fari Xhaferaj.

Balil Xhaferaj ishte dhe mbeti modeli i burrit lab, por edhe i njeriut mendjehapur në dritësimin e jetës së fëmijëve të tij. Xhaferajt kanë derdhur gjak në luftën për çlirim të vendit, por kanë pasur kontribute edhe në ndërtimin e shoqërisë sonë.

Te ky Hyso që përcjellim sot, ishin ngjizur tiparet trimërore të Hyso Xhaferaj të parë, i cili e dha jetën me armë në dorë, kundër ushtrisë greke kur pushtoi juglindjen e Shqipërisë, të ndërthurura ato tipare, me shpirtin e artistit të rrallë.

Ishte krenar që mbante emrin e tij, krenar për faktin që ishte nga Kallarati, e krenar për faktin që ishte lab, nga Lumi i Vlorës. Ashtu siç krenohet me birin e saj, Shoqata Atdhetare-Kulturore "Kallarati".

Ai ishte një patriot i zjarrtë kur vinte puna për çështjen kombëtare, dhe i pa përmbajtshëm, kur prekeshin vlera të qenësishme të identitetit tonë kombëtar.

Pas përfundimit të arsimit të mesëm, ai shërbeu për disa vite në Policinë e shtetit, me përkushtim dhe me përgjegjshmëri.

Në fakt, Tiranës me mundësitë e mëdha dhe me xhelozitë e saj të stërmëdha, i kishte ardhur një margaritar i fushës së artit, një artist i lindur dhe një interpret i pazakontë, e jo thjesht një nëpunës shteti.

Duke parë vlerat e tij vokale dhe cilësitë njerëzore, Ansambli i shtetit e mori në gjirin e tij. E nuk ishte fare e nevojshme të punonte dikush me Hyson si "fillestar" në atë Ansambël.

Përkundrazi, ishte Hysua ai që i erdhi jo vetëm një artist i arrirë, por edhe kontributor në përmirësimin e repertorit, e kryesisht të cilësisë së interpretimit.



Ai hyri vrullshëm në zemrat e artistëve të vërtetë të atij Ansambli. Ai i imponua kolegëve, sa me vlerat e tij artistike, aq edhe me vlerat njerëzore. Dhe u bë mik shpirtëror me shumë prej tyre.

Për Hyso Xhaferaj, nuk kishte rëndësi vendorigjina e miqve, mjafton që të ishin shqiptarë si ai, por edhe artistë si ai, në shpirt.

Ndoshta më i afërmi mik i tij, mbeti artisti i spikatur Lekë Pecnikaj, biri i Nikaj-Mërturit, nga Lekbibaj. Leka, i cili nuk e ka pirë më kafën e zakonshme, qysh ditën kur Hysua u sëmur, e që i qëndroi te koka në spital, përkrah familjarëve të tij.



Me Dekretin e Presidentit të Republikës me numër 9698, datë 12.07.2016 Hyso Xhaferaj u dekorua me Urdhrin "Naim Frashëri", me motivacionin "Përçues i spikatur i trashëgimisë kulturore kombëtare dhe lëvruar virtuoz i këngës shumëzërëshe, në skenat brenda dhe jashtë vendit". Hyso Xhaferaj gjatë shumë viteve që interpretoi në skenë, u bë një personalitet i spikatur i Kulturës kombëtare, brenda dhe jashtë vendit, në shumë skena të botës.



HYSO XHAFERAJ,

Bilbili që theu qelqet e qiellit me tingujt e zërit të tij

Përgatiti për gazetën: **Besnik GJONBRATAJ**

(Përmbledhje komentesh, vlerësimesh dhe krijimesh, bërë nga miq, shok, koleg, të afërm, personalitete të artit, kulturës e muzikës shqiptare, për jetën, aktivitetin artistik e shoqëror dhe kontributin në interpretimin e veçantë e me mjeshtri të këngës labe dhe jo vetëm, të birit të Kallaratis, "Bilbilit të Labërisë", Hyso Balil Xhaferaj)



Nderi i Kombit Lefter Çipa shkruante për të: "Hyso Xhaferaj është nga ata bilbila që thyen qelqet e qiellit me tingujt e tij, është një unazë trimi, me gur xhevahiri. Shteti jo më kot e ka radhitur Hyson, në radhët e zërave të bukur të Kombit. Në këtë trashëgimi të kombit shqiptar, Hyso Xhaferaj është një gur diamanti, brenda pedestalit të Kombit".

Vlerësime të larta për talentin e rrallë të Hyso Xhaferaj, ka dhënë profesor Zhani Ciko. Por Hysua rrëmbeu zemrën e Mjeshtër të Madh Rexhep Çeliku, interpretoi me Mjeshtër të Madh Hysni Zela, e doemos, me Mjeshtër të

Madhe Irini Qirjako, në Ansamblin e Shtetit.

Të tilla vlerësime kanë dhënë për të, Mjeshtër i Madh, profesor Muhamet Tartari, Mjeshtër i Madh Feti Brahimi dhe shumë, e shumë të tjerë.

Hyson e vlerësuan lart në veprat që realizuan me të dhe me Nazif Çelën, edhe kompozitorët më të mirë të kohës, ata më në zë që ka Tirana.

Pjesën më të madhe të veprës së tij artistike, Hyso Xhaferaj e ka realizuar me Bilbilin e pashok, Mjeshtër të Madh Nazif Çela.

Hysua e ndërtoi familjen e tij me Merita Lavdosh Seraj, bijën dinjitoze nga Brataj e Vlorës. Ata lindën dhe rritën dy djem dhe i arsimuan me mundësitë më të mira në Tiranë. Kjo familje, bashkë me vëllain e tij Bakon, ishin ata që i qëndruan në krah, në çastet e vështira të jetës së tij. Me përkushtim proverbial, të pa kufi.

Krah tij e në shumë plane, ishin doemos burrat fisnikë Nexhip Onjea, Trifon Golemi dhe Irfan Bilbili. Por edhe shumë e shumë të tjerë...



Nuk dihet se kush, cilët, i goditën gjakun artistit Hyso Xhaferaj. Gjaku mund të goditet, por ai kurrë nuk vritet dot. Sepse gjaku i tij, do vazhdojë të rrjedhë në familjen e tij, në veprën e tij artistike, si te pak të tjerë.

Do të vazhdojë për shumë vite, të endet në qiell pyetja torturuese PSE?!?

Edhe në brezat që do vijnë, të cilët kur të dëgjojnë interpretimet brilante të Hyso Xhaferaj, edhe ata, kur të mësojnë se është ndarë nga jeta në moshën 55 vjeçare, do të pyesin: **PSE?!?**- ashtu siç pyesin të gjallët e sotëm.

Do thonë brezat që vijnë "Po **PSE?!?**", duhej të ishte kaq i ri, ky zë i rrallë, në një moshë kur mund të jepte edhe më shumë?

Dhe pyetja këllthitëse **PSE?!?**, do të vazhdojë të thejë qelqet e qiellit, bashkë me zërin e rrallë të Hyso Xhaferaj.

Shumë gjëra mund të vriten, të ekzekutohen, madje edhe të zhduken nga faqja e dheut, por Vepra që le njeriu në jetën e tij, nuk mund të vritet dot.

Hyso Xhaferaj ikën i ri nga jeta, por ai largohet plot 100 vjeç, nga vlerat artistike që la pas. Vërtet, sa njerëz 100 vjeçarë, kanë mundur të lenë një vepër të tillë, të këtyre përmasave, e gjurmë të tilla të pashlyeshme?



Ndahet nga ne sot, një burrë bujar dhe qibar, një lumë i rrëmbyer me shpirt të pastër fëmije, i cili askujt nuk i bëri keq. Përkundrazi, ishte përkrah kujt do që kishte një hall, apo edhe një problem.

Djemtë e tij, duhet të jenë krenarë për babain e tyre. Ashtu siç ndjehemi të gjithë krenarë ne, që jeta na njohu nga afër e së largu, me Njeriun dhe Artistin Hyso Xhaferaj.

Sot vjen njëherë e përgjithnjë këtu në dheun e Tiranës, një shkëmb i madh nga Vargmali i Vetëtimës.

Me të gjitha vlerat me të cilat e pajosi Natyra, por edhe veprën e tij të pashlyeshme.

Në emër të gjithë këtyre vlerave, e në shenjë respekti të pafund, ju ftoj të mbajmë një minutë heshtje!

I pavdekshëm emri i tij, që do rrojë sa të rrojë vepra e tij!



FJALA E LAMTUMIRËS NGA DREJTORI I ANSAMBLIT KOMBËTAR TË KËNGËVE DHE VALLEVE POPULLORE, Z. SOKOL MARSI

Të nderuar familjarë, miq, shok e koleg të Hyso Xhaferaj. Në emër të institucionit të Teatrit Kombëtar të Operas dhe Baletit, dhe në emër të Ansamblit Popullor ku Hyso fali emocione pa fund nga muza e shpirtit të tij, me lejoni t'iu shpreh ngushëllimet më të sinqerta.



Sigurisht që kjo është një ditë e trishtuar dhe e pazakontë për të gjithë pasi po përcjellim fizikisht përpara kohe një mik nga më të dashurit dhe një artist me vlera të rralla. Është e pazakontë, pasi Hyso kishte shumë e shumë xhevahire për të nxjerr nga muza e polifonisë, ishte shumë i ri për të jetuar jetën dhe dashuritë e familjes së tij, ishte i pazvendësueshëm në tavolinat e shoqërisë. Por ja që jeta kjo është!

Një gojëdhënë e vjetër thotë se: Gjenitë ikin shpejt, dhe Hyso në artin e tij ishte

gjeni..., ishte gjeni sepse ishte unikal dhe i patjetërsueshëm në zërin e tij prej bilbili.

Hyso bilbili nuk do të këndoje më, por zëri dhe shpirti i tij do të jetojë me ne aq sa do të rrojë edhe polifonia labe.

Qofsh i parajsës i dashur Hyso! U prehsh në paqe! Pa harruar kujtimin yt!



AKTIVITETI ARTISTIK I HYSO XHAFERAJ NDËR VITE

I rritur në një ambient këngëdashës dhe i pasionuar pas këngës së bukur labe, shumë shpejt Hysua u bë një nga këngëtarët më të mirë e kryesorë të këngës labe kallaratase. Pas shumë vitesh të kënduarit labçe në dasma, sebesesh, festash të Kallaratis e deri në festivale

folklorike lokale, ku Hysua u poq, me punë e përkushtim arriti të bëhej pjesëtar i një ansambli mjaft të njohur, siç është Ansambli Shtetëror i Këngëve dhe Valleve Popullore,



Në vitin 2001 Hysua ka qenë solist me grupin "Buronjat Labe" me udhëheqës artistik të paharruarin, poetin e Labërisë, Nertesi Asallanin, grup i cili në atë kohë korri shumë sukses dhe albumi i hedhur në treg "Nëna qan me ligje" pati

kërkesa të jashtëzakonshme. Më vonë Hysua këndoi me grupin "Antea" e "Zadeja". Hysua këndoi përkrah të mirënjohurit, mjeshtër të këngës labe, Nazif Çelën dhe këngëtarët e tjerë, Mehmet Visha, Trifon Golemi, Sotir Ballo, Velo Çela, Andon Pango, Paro Ziflaj, Golig Jaupi, Neil Rucin, etj, me të cilët do të ishte bashkë në çdo event e gëzim familjarë. Por Hysua këndoi edhe në zhanre të tjera të muzikës së lehtë si me grupin e mirënjohur "West Side Family" me këngën "Nëse mundesh", me Aurela Gaçen, etj, duke u bërë shumë i dashur për publikun. Hysua do të mbahet mend për aktivitetin dhe rolin e tij të vecantë në përbërje të Ansamblit të këngëve dhe Valleve Popullore, me Hysni Zelën e Mjeshtër të Madhe, Irini Qirjakon. me aktivitete të shumta kombetare dhe nderkombetare si: Itali dhe gjithë Evropën, Amerikë dhe deri në Dubai.

Hysua me zërin e tij të veçantë këndoi me ansamblin, këndoi me Irinin, Nazifin e me shumë grupe të këngës labe, këndoi me Aurelën e grupin e famshëm "West Side Family". Këndoi me Irini Qirjakon, Vera Laçin e Dionis Delinë, këngën "Të humbur dërgoni lajme" me muzikë të kompozitorit të njohur Edmond Zhulali. E me kë nuk këndoi e do të këndonte Hyso Xhaferaj! Por siç shprehet gazetari inohur Aleksandër Çipa "Në këtë unikalitet Hyso Xhaferaj është i vetmi këngëtar shqiptar madje pse jo edhe i përbotshëm, që nuk la asnjë këngë të plotë si repertor të vetin, por krijoi unikalisht versionin e një këngëtari që shkëlqeu dhe do të shkëlqejë në tejkohësi përmes kryeveprës së introduksioneve vokale të vetvetes. Fatkeqësisht, ai kishte në përpunim rreth gjashtë këngë veti që do të formësonin të vetmin repertor unik dhe melodik, i cili për shkak të ikjes së parakohshme në amëshim, nuk u regjistrua dhe humbi në eternitet".

E ndërsa Hysua u nda fizikisht, zëri i tij mbeti këtu midis nesh në përjetësi dhe me siguri, ashtu sic kanë vërshuar poezitë për jetën e tij, me siguri së shpejti do të kemi edhe këngë kushtuar këtij bilbili, të cilat do ta bëjnë edhe më të pavdekshëm.



VLERËSIMET NGA PERSONALITETETË MUZIKËS, ARTIT DHE KULTURËS, NGA MIQ, SHOK, KOLEG E TË AFËRM PËR HYSO XHAFERAJ

Për Hyso Xhaferaj, në çdo kohë të jetës së tij, ka pasur vlerësime të shumta prej artistëve dhe profesionistëve të artit e të kulturës, në mënyrë të vecantë ato vërshuan pas ndarjes nga jeta. Ato janë të shumta, por midis tyre mund të veçonim:

Akordimin nga Presidenti i Republikës në vitin 2016 të titullit "Naim"



HYSO XHAFERAJ,

Bilbili që theu qelqet e qiellit me tingujt e zërit të tij

Përgatiti për gazetën: **Besnik GJONBRATAJ**

(Përmbledhje komentesh, vlerësimesh dhe krijimesh, bërë nga miq, shok, koleg, të afërm, personalitete të artit, kulturës e muzikës shqiptare, për jetën, aktivitetin artistik e shoqëror dhe kontributin në interpretimin e veçantë e me mjeshtri të këngës labe dhe jo vetëm, të birit të Kallararit, "Bilbilit të Labërisë", Hyso Balil Xhaferaj)

Frashëri" me motivacionin: **"Përçues i spikatur i trashëgimisë folklorike të Kurveleshit të poshtëm, në krahinën e Labërisë. Lëvrues virtuoz i isopolifonisë shqiptare në skenat kombëtare dhe ndërkombëtare".**



Poeti i madh, Lefter Çipa "Nderi i Kombit" e quante Hyson **"gur xhevahiri"**. Ja si shprehej ai në vitin 2014 në një intervistë dhënë për gazetën "Kallarati": "Hyso Xhaferaj është një bilbil pranë burimi, por është nga ata bilbila që thyen qelqet e qiellit kur lëshon spiralen e tij vokale nëpërmjet fosforikes labe, pra është një unazë trimi me gur xhevahiri. Hysua është një vlerë floriri që tingullin edhe pa ta futësh në dhe, edhe ta futësh në zjarr, edhe ta hedhësh në det të kripur nuk i ikën ndriçimi e tingëllimi. Ky është Hyso Xhaferaj nga Vlora e madhe e Labërisë, nga fshati më i dëgjuar në historinë e Rilindjes Kombëtare, nga Kallarati i Lumit të "bardhë" apo i lumit të "nxituar" që i këndon Ali Asllani. Shteti jo më kot e ka radhitur Hyson në radhët e zërave të bukur të Kombit. Ai është një nga zërat më të bukur të kombit, sot në këtë epokë që di t'i këndojë historisë pa i prekur jastëkun. Se

shkopi i historisë po qëlloi jastëkun e kokës do të thotë ka shkatërruar kombin. Tek ne kombin akoma e mban trashëgimia shpirtërore. Në këtë trashëgimi të kombit shqiptar, Hyso Xhaferaj është një gur diamanti, brenda pedestalit të kombit".



Teatri Kombëtar i Operës, Baletit dhe Ansambilit Popullor. Institucioni dhe shtëpia ku Hysua për 20 vjet rresht u perfeksionua si këngëtar dhe shpalosi me dinjitet e profesionalizëm të lartë talentin e tij artistik, duke u bërë i njohur brenda e jashtë vendit, në lajmin e dhënë për ndarjen e parakohshme nga jeta të Hyso Xhaferaj, pasi bën vlerësimin artistik e njerëzor,

e quan atë **"Një zë unik në mbarë polifoninë shqiptare dhe një artist me vlera të jashtëzakonshme"**. Më tej ata shprehen: "Teatri Kombëtar i Operës, Baletit dhe Ansambilit Popullor, me hidhërim të thellë mësoi për ndarjen e parakohshme nga jeta, në moshën 55-vjeçare, të artistit Hyso Xhaferaj, njërit prej artistëve më të mirë të Ansambilit Kombëtar të Këngëve dhe Valleve Popullore dhe artit të Polifonisë Shqiptare. Hyso Xhaferaj prej afro 20 vitesh interpretoi me shumë sukses së bashku me grupin e Ansambilit Popullor këngën polifonike brenda dhe jashtë vendit. Ai ishte një zë unik për mbarë Polifoninë Shqiptare. Publiku, miqtë dhe kolegët do ta kujtojnë këtë artist me vlera të jashtëzakonshme për interpretimet e tij të mrekullueshme me zërin e bilbilit. Teatri Kombëtar i Operës, Baletit dhe Ansambilit Popullor i shpreh ngushëllimet familjarëve, të afërmeve, miqve, bashkëpunëtorëve dhe admiruesve që e duartrokitën gjatë gjithë karrierës së tij. I paharruar kujtimi i Hyso Xhaferaj! U prehtë në paqe!"

Gazetari i njohur, Aleksandër Çipa "Zëri i solistit Hyso Xhaferaj, një fenomen vokal shqiptar, ndaj të cilit çdo kompozitor e muzikant ndihet në faj e kompleks. Është, ai zëri qiellor që shijojmë të kënga e grupit aq të dashur "West side family", apo te kënga e Aurela Gaçes. Një talent kombëtar me kontribute magjike dhe shfaqje modeste individuale, të cilin Ansambli i Shtetit apo edhe Teatri Kombëtar i Operës



kanë arsyen e plotë ta shfaqin si "zërin e çuditshëm" të zërave tanë. Do të duhej me kohë të ndalej kushdo prej studiuesve të etnomuzikës dhe muzikologjisë tek ky zë, tek fenomeni vokal dhe

interpretativ i një këngëtarit kaq unik, i një interpretuesi aq të hollë dhe me finesën magjike që tejkalon shamin interpretativ të çdo zonje arti, që sfidon instrumentet, kryesisht violinën dhe që magjishëm të jep elementët e mistikës njerëzore, kryesisht asaj të shpirtit që mund të gjenerojë si asosacion zëri unik".

Shkrimtari, Albert Zholi, në shkrimin "Këngët e Maleve të mia", shkruar ne 11 Maj 2011 e vlerëson Hyson në këtë mënyrë: Hyso Xhaferaj "Një pritës me zë të rrallë, në dhjetëra këngë të mrekullueshme që tashmë janë pjesë e fondit tonë të artë të këngës popullore, solist i Ansambilit Popullor".

Këngëtarja Iriqi Qirjako "Mjeshtrë e Madhe" e quan Hyson: "Një njohës i labërishtes dhe është hedhës brilant i këngës labe".

Muzikanti, Sokol Marsi: "Luanët një vdekje kanë" "Natyra të bëri bilbil, ndaj zëri yt do të

jetojë me ne, aq sa jeton edhe Polifonia! "Hyso bilbili nuk do të këndojë më, por zëri dhe shpirti i tij do të jetojë me ne, aq sa do të rrojë edhe polifonia labe".

Aktori, Bujar Asqeriu: Lamtumirë Hyso Xhaferaj, lamtumirë o djalë, o vëlla, o artist! Do mbetesh i paharruar për të gjithë ne që të njohëm, punuam e kaluam një pjesë jete së bashku! Pusho në paqe miku ynë!

Maestro Zhani Ciko: "Zëri i Hysos është unik dhe një pasuri krenuese për trupën tonë profesionale të Ansambilit të Këngëve dhe Valleve Popullore".

Kryetar i shoqatës "Labëria", Ago Nezha: "Labëria humbi birin e saj fisnik, Hyso Xhaferajn, një talent i rrallë që rrezatonte mirësi, dashuri, bujari dhe fisnikëri".

Rapsodi, Muhamet Tartari "Mjeshtrë i Madh": "Kallarati dhe kënga labe kanë humbur një këmbë mali! Hyso Xhaferaj, një zë i veçantë i këngës sonë të mrekullueshme labe, fatkeqësisht nuk është më mes nesh. Një sëmundje e pabesë e mori atë nga familja e tij, miqtë e shokët, nga polifonia që aq shumë e donte. Hysua, bir i një familjeje me emër nga Kallarati të Labërisë, e shkroi emrin e tij mes këngëtarëve më të mirë të trevës sonë. Anëtar i Ansambilit Kombëtar të Këngëve e Valleve në Tiranë, Hysua ynë ishte ura lidhëse mes marrësit dhe hedhësit, ishte pararendësi i isos. Ishte ai që i shtonte lezetin çdo kënge labe dhe zbukuronte".



Këngëtarja, Aurela Gaçe: "Muzika në zi. Ndahet nga jeta artisti i njohur shqiptar, bilbili i polifonisë Hyso Xhaferaj. Sot, lexova ndër miq, lajmin e hidhur për largimin nga kjo jetë të këtij bilbili të rrallë, Hyso Xhaferaj. Polifonia i rridhte në deje, në vena. Pata fatin ta kisha në skenë, në disa momente të veçanta skenike, aty ku doja të dëgjohej bukur e të merrte vlerat e vërteta Polifonia jonë, patjetër

në krahë do të kisha Hyson. Pasuri zëri i tij. Ngushëllimet e mia më të sinqerta, familjes, miqve e gjithë dëgjuesve të zërit të rrallë. U prehsh në paqe!"

Këngëtarja, Nazif Çela: Këto vargje ia dedikojmikut tim të shpirtit, Hyso Xhaferaj. *Hyso trëndafil i majit / vëlla e shkuar vëllait / lashë këngën, ia nisa vajit / Pasha shkuar Pashait / ligjëroi lëmin e fatit / Hyso Balil gojëmjalti / gjuhë bilbil i Kallararit / shkoi pranë Lefter namllartit / o fosforin Labërie / spirale polifonie / prehu në qiell përjetësie / aty losë e qesh me yje.*



Këngëtarja, Paro Ziflaj: "Hyso Xhaferaj ishte mjeshtrë i pakrahasueshëm me asnjë deri më sot, kishte talent e virtyte për hedhës, marrës, kthyes që s'i bën çdokush. Fati i tij dhe joni që nuk do ta kemi më fizikisht". Hyso

xhani, Hyso djali / Që sot na piku malli.

Këngëtarja, Tomorr Lelo: *Hysua me shpirtin flori / Me buzëqeshjen farfuri / Nxitoi për në përjetësi / Atje te idhujt e tij / Në krah të tyre të rri / Ne na la me lotë në sy...*

Këngëtarja kallaratase, Evgjëni Jonuzaj: "Para pak pandemisë në një bisedë me Hyson menduam të realizonim disa këngë me grupin polifonik të fshatit duke përfshirë të gjithë brezat edhe një elegji me Hyson, Zeqon dhe unë. Por nuk qe e thënë, se ti ike para kohe, ike pa na lajmëruar. Ike atje lart në qiell, ku ti nuk duhej të ikje. Ike dhe na le të shtangur. Të jap fjalën që ne do ta realizojmë, sepse zërin tënd e kemi këtu midis nesh, zërin nuk e more me vete, na e le si kujtim për gjithë jetën".



Mësuesja, Luiza Gjonbrataj: "Do mbetesh përjetësisht në zemrat tona, miku ynë, duke të kujtuar si njeriun më fisnik e fjalëmbël që kemi njohur. Gjithmonë jam ndër të krenare për zërin tënd që buronte nga shpirti yt si ujët e burimeve të Kallararit tënd të dashur. Më bëre krenare para gjithë kolegëve dhe nxënësve të mi të shkollës "Lasgush Poradeci", ku me zërin tënd bilbil këndove për ne këngët e bukura të atdheut tonë. Një bilbil i këngës labe si ti nuk ka për t'u shuar kurrë".

Këngëtarja i grupit West Side Family, Roland (Landi) Hysi: Pa fund i trishtë lajmi i ikjes së Hysos! West Side Family, por edhe unë do të të kujtojme me projektet xhevahire pa çmim! U prehsh në paqe!

Artisti, Vendim Kapaj: "E pa besueshme për ndarjen nga jeta të mikut dhe kolegut tonë Hyso Xhaferaj. Ti rrojnë të gjithë të dashurit e tij!"



HYSO XHAFERAJ,

Bilbili që theu qelqet e qiellit me tingujt e zërit të tij

Përgatiti për gazetën: **Besnik GJONBRATAJ**

(Përmbledhje komentesh, vlerësimesh dhe krijimesh, bërë nga miq, shok, koleg, të afërm, personalitete të artit, kulturës e muzikës shqiptare, për jetën, aktivitetin artistik e shoqëror dhe kontributin në interpretimin e veçantë e me mjeshtri të këngës labe dhe jo vetëm, të birit të Kallaratis, "Bilbilit të Labërisë", Hyso Balil Xhaferaj)

Poeti, Kristo Çipa: "Në bardhësinë e kësaj bore dhe në pikëllimin e këtyre reve vetull puja shpirti i Hyso Xhaferaj mori udhëtimin fluturues atje ku shkojnë shpirtat e fëldishtë. Na la pas mijëra tingëllima drithëruese dhe mori me vete para kohe dëshpërimet e familjes, miqve dhe artëdashësve. Këngën deshi në këngë shkoi. Kjo është përcjellja ime që kurrë nuk doja që ta sillte jeta".

"Mos besoni asnjëherë / Se ka ikur ari i verdhë / Ia merr këngës me të dredhë / Na thotë: Zgjohuni të mjerë / Këndoni si unë përherë"

Muzikanti, Edmond Zhulali: Ngushëllime familjes e Ansambilit për humbjen e një artisti dhe njeriu të mrekullueshëm.

Këngëtari, Mihal Kaçi: "Hysua ishte një nga zërat brilant të rrallë që kishte lindur kjo tokë. Zëri i tij ishte dhuratë qiellore që ngjasonte me meloditë e engjëjve. Me hedhjen e tij ai "thyeu qelqet e Qiellit", siç e përshkruante "Nderi i Kombit", Lefter Çipa. Hysua ishte një nga miqtë e ngushtë të Zagorisë. Ai e deshi shumë këtë krahinë dhe e vlerësonte për arsimin e kulturën, traditat dhe këngët e saj. Hyso Xhaferaj ishte nga ata gjeni që Zoti i deshi për vete, pasi erdhi në këtë jetë dhe iku shpejt duke lënë një pasuri të madhe në breza". *Ligjëron sot kënga labe / Flamuri në gjunjë ka rënë / Ku vajti Hyso Xhaferaj, / Shpirti që jeton në këngë.*

Poeti, Polo Çipa: "O bilbil i lindur, o zemer behari, ike tepër, tepër nxituar, ike shumë para kohe miku im, artist i këngës, ndoshta të thërriti vetë zoti për të mjaltësuar parajsën me atë zërin tënd magjik. Ike, ike miku im në rrugën e moskthimit, veçse thellë në zemrat tona mbolle "Lulen e Kujtimit". U përfsh në paqe, o engjëll, o bilbil i Labërisë!".

Bir i Labërisë legjendë / ti ngele një këmbë mali / nektar i këngës në skenë / për ty do na marrë malli.

Poeti, Nexhip Onjea: "Pse vëlla, pse u nxitove / "preve" në besë shoqërinë? / Përse këngën e pushove? / Helmove gjithë Labërinë".

Flautistja, Parashqevi Hallko (Çipa): "Zëri brilant dhe buzëqeshja e bardhë e Hyso Xhaferaj do na mungojë shumë. Ka vajtur të këndojë me babain tim. Zëri i Hysos do të kujtohet përherë. Hysua do i mungojë familjes, shoqërisë, miqsisë, do i mungojë këngës shumëzërëshe. Zëri i Hysos do jetë i pranishëm në shekuj. Ai ishte brilant në pamje, në shpirt dhe në zë. Hyso më përqafo babain! U prehsh i qetë".

Gazetari, Sejmen Gjokoli: "Pushoi këngën Bilbili / Hyso Xhaferaj, si ylli / Hyso këngën pse pushove / Pse kaq shumë na helmove? / Kallarati të kish djalë / Labëria këng' në ballë / Ike të ndriçosh me yje / Mbetë këngësh, Labërie".



Këngëtari, Andon Pango: "Hyso Xhaferaj, virtuoz i polifonisë, miku im nga më të mirët nuk është më midis nesh po parajsja po e pret. Nxitoi të na e merrte kaq shpejt se ajo i do të mirët. Na le një brengë e trishtim o i miri Hyso. I pavdekshëm do mbetesh se kënga jote nuk harrohet. Do të na shoqërojë si kolonë zanore gjithë jetën".

"Pikëllim! Nuk na besohet. Sot tre ditë pa zërin e bilbilit, pa humorin e tij dhe pa qenien e tij babaxhane. Më është ngulitur në mëndje telefonata e fundit me të. Unë i fola ai ma ktheu me këngë "U thafsh moj dega dafinë, s'më lë të shoh Zagorinë". Më tha jam optimist, nuk e lëshoj veten, por sëmundja e theu. Nuk do ta harrojmë kurrë".

Gazetari, Aleksandër Çipa "Një artiste në lotin e rikthimit", Gazeta Shqip, 3 nëntor 2014.



Po gazetari, Aleksandër Çipa, duke marrë pjesë në një aktivitet në Vlorë në promovimin e disa librave të atit dhe të tijat më 3 nëntor 2014, e ndërsa flet për Qirjako Balën, si kthyesi më jetëgjatë i grupit të Pilurit, për të cilin ekspertët e kantos dhe të mjeshtërisë vokale shtojnë njëzëri se kemi të bëjmë me një rast të pastudiuar dhe të pavëzhguar "laboratorikisht" ka pak vite që gjendet në jetën e amëshuar- më tej shton se: "Një zë i tillë i rrallë gjendet sot edhe në trupën e Ansambilit Shtetëror të Këngëve dhe Valleve,

që i përket këngëtarit Hyso Xhaferaj. (Për kujtesë dhe vëmendje të lexuesve, e kam fjalën për atë zërin që përdoret si introdukt vokali të kënga e njohur e grupit "West side family", e cila të shëmbëllen se vendos një lidhje mes Qiellit dhe Tokës. Maestro Zhani Ciko para pak kohësh shprehej se zëri i tij është unik dhe një pasuri krenuese për trupën tonë profesioniste. Por natyrisht, sikundër është lënë në "shejtninë e tij" të heshtjes, pra pa u komentuar prej studiuesve apo mjeshtreve të fenomeneve vokale, zëri i Hysos, në një heshtje të tillë, më shumë se 20-vjeçare, është edhe e talentuara dhe virtuozja Ermioni

Mërkuri"-përfundon Aleksandër Çipa.

Gazetari, Pano Hallko: lku një artist, i pa ngjashëm me askënd tjetër. Është shembulli i vetëm, në kulturën shqiptare, që nuk u arsimua për muzikë, por që shkëlqeu në Muzikë, si shumë pak të tjerë në këtë vend. Natyrshëm, lind pyetja: - Po ku e mësoi ky Artist, muzikën sipërane? Dhe përgjigjja, është vetëm një fjalë. Geni. E kishte nga geni, i trashëguar ndër shekuj.

Këngëtari, Lekë Pecnikaj: Unë kam kaluar orët ma të mira të ditës me Hyson dhe e ndiej shumë mungesën e tij. Ah more Hyso vëlla na le pa fjalë. Sa e vështirë të futem në punë pa ty. Më mungon në krah, në skenë, në kafe, në turne. Po na ke lanë zanin. Ke lanëdy yje. Na ke lanë shumë kujtime. U përfsh në paqe vëllai im. I përjetshëm kujtimi i yt!

Këngëtarja, Katerina Beleri: Lajm i rëndë dhe shumë i hidhur. Shpreh ngushëllimet më të sinqerta, t'i rrojnë femijët! Pushoi këngën bilbili! U prehtë në paqe bilbili i Labërisë!

Riza Memushaj: *Labçes do i mungojë / hedhsi i saj më i shquar / Por kënga s'do të ndalojë / E zëri yt s'ka për t'u shuar.*

Këngëtari, Neil Ruçi: Njerëz të tillë si Hyso Xhaferaj, janë të rrallë, dhimbja është për këdo, sidomos për familjen, fisin, shoqërinë e miqësinë, por për ata që kanë qenë afër tij e ka bashkuar zërat me një harmonizim që ta kishte endja ta degjoje, do t'ju mungojë shumë. I përjetshëm kujtimi i tij!

Festime Veshaj (Xhaferaj), motra: *Ç'farë ka syri që loton / po kjo zemër pse u çaq? / Për vëllanë shpirti vajton / se na u këput njëri krah.*

Dorian Demiri: "Lamtumirë Bilbili i Këngës labe, Hyso Xhaferaj, do të mbetesh gjithmonë në pedestalin e njeriut të mirë dhe me vlera, njeriut artist të merituar të Kallaratis!"



Fatmir Toçi, ish deputet, botues: "Ngushëllime familjes dhe të dashurve! E kam njohur nga afër, bilbilin e Lumit të Vlorës dhe gjithë Labërisë! Do të mbetet i paharruar për emrin e mirë që la pas dhe këngën polifonike që këndoi gjithë pasion e virtuositet. I paharruar kujtimi i tij!"

Thoma Dilo: "Na iku në parajsë miku jonë, Hysua. Na dhemb shpirti për këtë njeri të mirë, për këtë burrë buzëqeshur, për këtë artist të madh të polifonisë. U prehsh në paqe Hysua ynë fisnik! Sa shumë do na mungosh! Lamtumirë Hyso! Nuk do të harrojmë kurrë!"

Vangjel Asllani: "Hidhërim i thellë për humbjen e atij bilbili, miku i ngushtë me këngën labe që e deshi dhe e interpretoi aq bukur, miku ynë i të gjithëve që kemi njohur buzëqeshjen dhe zemrën e tij të madhe e të pastër. Kallarati humb një bir të denjë, shoqëria një shok e mik të veçantë dhe kënga labe një bilbil të rrallë. U prehsh në paqe, o njeriu e shoku ynë i mirë, o zëri i bukur i Labërisë, Hyso Xhaferaj".

Këngëtarja, Ermira Kola (Strataj): "Ngushëllime të sinqerta për artistin, bilbilin e jugut dhe mikun tim Hyson....Dhimbje për moshën, për shokun, për humbjen e polifonisë Labe. U prehtë në paqe shpirti i tij!"



Besnik Gjonbrataj: "E pabesueshme, e papranueshme dhe shumë prekëse largimi para kohe nga jeta e vëllait, shokut dhe mikut tim dhe të gjithë neve, këngëtarit Hyso Xhaferaj. Intervista me ty e pazbardhur është një kujtim, pasi zëri jot dhe fjalët e bukura të mbetura në memorjen e celularit, shumë shpejt do të jenë një kujtim për familjen tënde dhe për të gjithë ne. Bashkë kishim edhe plane të tjera, ti me këngëtarët e tjerë kallaratas për të kënduar e unë për të shkruar, por sëmundja u tregua e pamëshirshme. Do na mungosh o gojmjalti Hyso, që gjithë jeta jote shkurtër ishte veç dashuri për njerëzit dhe dashuri për këngën. Do i mungosh familjes, miqve e shokëve, bashkëfshatarëve të tu kallaratas, vendlindjes që e deshe aq shumë, do i mungosh Polifonisë Labe, e cila humbi zërin më të veçantë të saj, zërin ndoshta të paarrishëm, por ti Hyso do jetosh thellë në zemrën e kujtdo që të njohu, sepse kënga e zëri yt nuk do të

kenë kurrë vdekje. Ti do ngelesh për të gjithë ne "Hysua i Këngës Labe". U prehsh në Paqe!"

Minella KURETA: "Ooo sa e dhimbshme! Një bilbil, kanerina e polifonisë, ndahet nga jeta. Ngushëllimet më të thella për familjen në radhë të parë dhe për tërë artistët e artdashësit e polifonisë shqiptare. I ndritë shpirti në parajsë!"

Sotir Arben Çika: "U prehtë në paqe bilbili Hyso Xhaferaj. Ishte bilbil i pazëvendësueshëm dhe unikal në llojin e vet. Ne si familje Çipa do të na mungojë përherë".



HYSO XHAFERAJ,

Bilbili që theu qelqet e qiellit me tingujt e zërit të tij

Përgatiti për gazetën: Besnik GJONBRATAJ

(Përmbledhje komentesh, vlerësimesh dhe krijimesh, bërë nga miq, shok, koleg, të afërm, personalitete të artit, kulturës e muzikës shqiptare, për jetën, aktivitetin artistik e shoqëror dhe kontributin në interpretimin e veçantë e me mjeshtri të këngës labe dhe jo vetëm, të birit të Kallararit, "Bilbilit të Labërisë", Hyso Balil Xhaferaj)

Vangjel Frroku: "Hyso Xhaferaj, talenti i shekullit. Emocionohet çdo qenie njerëzore kur dëgjon zërin e tij si bilbil".

Kanan Canodemaj: Dhimbe dhe humbje e madhe për familjen e Hysos, të afërmit, miqtë e shokët, por dhe për këdo shqiptar për këtë bir të familjes Xhaferaj, Kallararit, Labërisë dhe gjithë Shqipërisë, sepse ai ishte një personalitet dhe artist i rrallë për të gjithë. I paharruar qoftë kujtimi i tij brilant. Ngushëllime familjes së nderuar Xhaferaj!

Liliana Gjika: "Jam befasuar nga kjo këngë (kënga e nënës, kënduar me Irini Qirjakon). Dy zëra të veçantë, të mrekullueshëm, veçanërisht zëri i Hyso Xhaferaj. Nuk besoj se do të ketë të tillë zë ndonjë këngëtar tjetër. Do të kujtohet përjetësisht nga zëri i tij bilbil".

Kristina Sakaj: "Hyso Xhaferaj me zërin e tij të manitshëm të ngulitet në mendje. Zë bilbili i pakrahueshëm. Të mirët nuk rrojnë shumë. I përjetshëm kujtimi i tij".



Pëllumb Gjonbrataj: "Iku zëri virtuoz dhe i papërsëritshëm i këngës labe në kohën kur vet polifonia labe kishte nevojë për Hyson. Qofsh i përjetshëm, Hyso Balil Xhaferaj".

Bujar Rrapaj: "Një jetë e padrejtë, një zot pa kuptim dhe një marrje jete në mesin e jetës për një djal të rrallë që njëherë lindi dhe kurrë nuk vdesin në memorien e të gjithë labërisë. I qoftë dhe i lehtë vëllait, shokut e mikut tonë! U prehsh në paqe vëlla".

Xhevdet Demiri: "Lamtumirë Hyso Xhaferaj. Qofsh i parajsës, o njeriu i mirë, djali me vlera i Kallararit. Kurajo Balilit, Bakos, motrave, bashkëshortes dhe djemëve".

Neki Xhaferaj: "Lamtumirë o bir i xhaxhit që të desha shumë. Më ike shpejt o djal. Lotët e mi do të jenë gjithmonë mbi faqen tënde. Lamtumirë o bilbil i këngës".

Murat Tahiraj: Në radhë të parë i përcjell ngushëllime familjes të të ndjerit. Hyson e kam njohur nga afër në takime me miq e shokë të tjerë vranishtjotë, në ceremonira që organizonim kolektivisht, por për faktin se unë jam rritur në kufi me fshatin Kallarar, kam njohur edhe të tjerë të afërm të Hysos dhe familjes së tij dhe nëpërgjithësi më është krijuar një respekt për të gjithë fisin Xhaferaj. Hysua ishte një djal i përsosur, një artist i rrallë me zërin e tij "VIOLINË", që nuk ia gjëje kollaj shokun për interpretimet me zërin e tij. E konsideroj fatkeqësi edhe për artin shqiptar humbjen e tij. Rrallë në kohëra, natyra ua jep këtë dhuratë të veçantë, por Hysos ia kishte dhuruar. I paharruar do mbetet emri dhe vepra e tij.



Studius, Bashkim Abazaj: Njeri dhe artist i madh. Miki mrekullueshëm, gojëmbël dhe me shpirt human. Artisti dhe krijuesi u japin rrugëtime pa fund ndjenjave. Ato nuk harrohen, nuk treten. Zëri i Hysos është në hapsirë dhe do të shfaqet, rizgjohet. Tingulli i pazakontë do të përshkojë në çdo gjëmim të këngës popullore. Ai është dhe do të jetë. Dheu i lehtë mik i paharruar".

Yli Rjepaj: "A, o Hyso Xhaferaj, na lëndove vëllai ynë, shoku i vegjëlisë do tena mungosh Hyso, por kënga jote dotë mbes për jetë të jetëve. Lamtumirë Hyso! U prefsh ne paqe".

Luto Demiri: "O çfarë lajmi i hidhur! Bilili, Bako, motrat, bashkëshortja, djemtë e Hysos humbën njeriun e shtrenjtë të zemrës. Fshati Kallarar humbi një njeri me vlera, por zëri i tij brilant do të dëgjohet gjithmonë! Ngushëllime".

Kastriot Sadikaj: "Këto janë trishtime që nuk paragjykojnë. Shumë u preka dhe më ikën lotët. Shpreh ngushëllime të sinqerta për vëllain, motrat gjithë fisin Xhaferaj në fshatin Kallarar, gjithë shoqatën Kallarati. Kënga e polifonisë humbizërin më me vlera artstike. Ne bashkëmohatarët e tij humbëm shokun tonë, për të cilin ruajmë kujtimet më të paharrueshme. Hyso Xhaferaj do të jetë i gjallë, sa vetëkënga që ai u rrit me të".

Kastriot Qejvanaj: "Nuk e besoj të ketë pushuar zemra e Hysos. Ai është i pavdekshëm se ashtu e kish krijuar zoti, por dhe parajsa kish nevojë për të. Hyso! U prefsh në parajsë".

Kristo Bushaj: "I pa harruar emri dhe kujtimi i Hysos, ARTISTIT të lindur, që na dha aq

shumë kënaqësi e buzëqeshje, prandaj sot për të burojnë lotë e dhimbje".

Asqeri Hysaj: I pabesueshëm ky lajm për ndarjen nga jeta të njeriut të mirë, i qeshur dhe gojëmbël. I dashur me të gjithë, i kudondodhur në ekranet e këngës. E rëndë për dajon tonë në moshë të madhe për këtë goditje, për vëllain, motrat, bashkëshorten, fëmijët dhe gjithë të afërmit e tij. Ngushëllime, u preftë në paqe. Zëri i tij do të vazhdojë ta mbajë gjallë midis këngës. U prefsh në paqe bilbili i këngës!



Pajtim Hasanaj: Ngushëllime familjes së tij për humbjen e parakohshme të njeriut të tyre të dashur, një humbje e dhimbje edhe për fshatin Kallarar, për miqtë e shokët e tij, por edhe për këngën labe që ai e donte dhe e interpretonte me pasion e mjeshtri. Kam patur rastin të njihesha me të e ruaj kujtime të mira për afërsinë, ngrohtësinë, çiltërsinë e buzëqeshjen e tij të përhershme në fytyrë e në shpirt. Lamtumirë miku i mirë, Hyso Xhaferaj!

Gëzim Mataj: Dhimbe e madhe për vëllain tonë, bashkëfshatarin, shokun e mirë, këngëtarin e ëmbël, Hyso Xhaferajn. Rëndom thuhet i paharruar kujtimi i tij, por ti vërtet do ngelesh i paharruar për të gjithë.

Edmond Breshanaj: Ngushëllime familjes, kujtesë dhe mirnjohje për Hyson, do t'i mungojë shumë familjes dhe shoqërisë, do i mungojë këngës labe. I paharruar kujtimi i tij, sidomos për ne që u rritëm me të!

Namaz Tozaj: Po ku të gjeti, o djal! Shumë zemra lëndove. Uroj të të rrojnë djemtë dhe ti u prefsh në paqe, o bilbili i skenës!

Liri Shkurtaj: I pa harruar kujtimi i Hysos! Ai u largua fizikisht dhe la prapa këngën dhe zërin e bilbilit, që do vazhdojë të këndojë për të afërmit, për bashkëfshatarët dhe për të gjithë grupin e Ansambllit të Këngëve dhe Valleve Popullore! U prehtë i qetë në parajsë, Hyso Balil Xhaferaj!



Lefter Qejvanaj: Të shokuar për lajmin e hidhur për ndarjen nga jeta parakohe të bashkëfshatarit, shokut tonë, bilbilit të lumit të Vlorës, Hyso Xhaferaj! I shprehim familjes dhe të afërmit ngushëllime tona. I qoftë dhe i lehtë! Dhembjen në forcë për njeriun e zemrës!

Shkëlqim Kelo: Ngushëllime familjes, miqve dhe shokëve për këtë humbje të madhe të njeriut të tyre të dashur, mikut e shokut tonë, që është si një tërmet për Kurveleshin e Labërinë. Qoftë i Parajsës!

Rajmonda Breshanaj: Sa shumë dhimbje përcjell për të gjithë, aq sa buzëqeshje ai si askush tjetër dhuronte. Zoti tu jap forcë gjithë familjarëve për të kapërcyer këtë humbje të madhe.



Xhelo Tozaj, dajua: Jeta nis me ditëlindjen e mbaron me ditëvdekjen, kurse për artistët (si Hysua) është ndyshe, ajo nis me këngën e më s'pushon. Hysua përveçse një artist i rrallë, ishte familjar i përkushtuar me një bashkëshorte shëmbullore dhe dy djem të mbrekullueshëm. Hysos iu bë një përcjellje shëmbullore, organizuar nga asambli dhe shoqata Kallarati. Hysua u largua fizikisht, por pas ka lënë zërin e tij që do e dëgjojmë në çdo kohë që do të na marrë malli. Madhështia e ceremonisë reflektohej nga pjesëmarrja dhe vleresimi i artistëve të mëdhenj dhe bashkëfshatarëve të tij të shumtë. Prehu në paqe Hyso Xhaferaj për emrin e mirë që ke lënë në shoqëri e në art".

VLERËSIME E KRIJIME LETRARE KUSHTUAR FIGURËS ARTISTIKE TË HYSO XHAFERAJ PËR NDARJEN E PARAKOHSHME NGA JETA

KOMENTE TË SHUMTA, VLERËSIME PAFUND PËR FIGURËN E HYSOS NGA FAMILJARËT, TË AFËRMIT, MIQTË E SHOKËT E TIJ TË SHUMTË, BASHKËFSHATARËT DHE KOLEGËT E PUNËS DHE ARTISTËT NË PËRGJITHËSI. KJO TREGON PËR SHPIRTIN E MADH NJERËZOR DHE ARTISTIK TË KËTIJ NJERIU TË PAARRITSHËM ME ZËRIN E TIJ TË VEÇANTË E TË BUKUR. ËSHTË E PAMUNDUR T'I BOTOSH TË GJITHA, POR NJË PËRZGJEDHJE TË TYRE, MUND T'I LEXONI MË POSHTË.

ALEKSANDËR ÇIPA, GAZETAR

Teli i zërit tënd çon Shqip-en tek Zoti
Kushtuar këngëtarit unik Hyso Xhaferaj*



*Tel i zërit tënd lidh jetë e vdekje bashkë,
Në tokë e qiej hedh - muzikë me zanore,
Na ike shpejt, në atë fat komete,
Që s'kthehet përsëdyti më tek këto sinore.*

*Kometë e zërit tënd përjetë mbeti këtu,
Dhe ne që ta lexojmë me lot e lajmë atë kod,
Si mit i rrallë, një këngë të vetme nuk na le,
Veç spiralen* e kthejmë e nuk e shtojmë dot.*

*Kërkojmë tek Doktor Flori, po veç një introduktë,
E kapërcen njerëzinë, raketa e zërit tënd?!
Në copëza diku e mbledhim gjithë muzikën,
Dhe vetëm për një zëmër të plotë na zë vënd.*

*Mjafton zgjatim i zërit të lidhë Tokë e qiej,
Të gjejë të pagjendshmen në qiejt gjithë mister.
Zanore e shqipes tënde, kulluar në labërishte,
Shpirtin e gjithësisë si thikë po na e ther.*

*Veç ti që na ildise me atë zë filigramik,
Balada që kanë rrokje dhe nuk u duhen fjalët,
Të gjitha hapësirat dhe elegjitë i mblodhe,
Në vatër të një "i"-je që nuk i duhen flakët.*

*Për kohrat që do vijnë e nuk i duken botës,
Zanorja jote qelq, tejçuesja si loti,
Pas mjegullash mërzhish dhe vaje elegjiake,
Me tel të zërit tënd, Shqip-en na çon tek Zoti*

*Solist i Asambli Shtetëror të Këngëve dhe Valleve Shqiptare i cili ndërroi jetë pak ditë më parë.
Spiralen*- zgjatimi vokal i këngëtarit tek introdukta e këngës " Nëse mundesh" të Grupit West Side Family të cilin miku i tij poeti Lefter Çipa e quante:spirale qiellore

RAPSODI, MUHAMET TARTARI "MJESHTËR I MADH" Homazh për Hyso Xhaferaj



Ç'u këput një këmbë mali... vajtonte aq bukur dikur Zeqo Hoxha. Kjo baladë humbjeje dhe dhimbjeje, ishte e madhe dhe e rëndë sa Bogonica mbi Kallarat. Po i shkruaj këto radhë sepse Kallarati dhe kënga labe kanë humbur një këmbë

mali! Hyso Xhaferaj, një zë i veçantë i këngës sonë të mrekullueshme labe, fatkeqësisht nuk është më mes nesh. Një sëmundje e pabesë e mori atë nga familja e tij, miqtë e shokët, nga polifonia që aq shumë e donte. Hysua, bir i një familjeje me emër nga Kallarat të Labërisë, e shkroi emrin e tij mes këngëtarëve më të mirë të trevës sonë. Anëtar i Ansambli Kombëtar të Këngëve e Valleve në Tiranë, Hysua ynë ishte ura lidhëse mes marrësit dhe hedhësit, ishte pararendësi i isos. Ishte ai që i shtonte lezetin çdo kënge labe dhe zbukuronte.

E përcjell në përjetësi me vargjet e mia.
I paharruar do jesh i dashur Hyso!

*Eja o Hyso Xhaferi,
Se të pret ty shoqëria,
Eja lehtë me çap dreri,
Se të pret polifonia.*

*Të pret ansambli kombëtar,
T'ja thuash siç di vetë,
Me zërin tënd longar,
Hyso mjeshtri i vërtetë.*

*Hyso Xhafer Kallarati,
Ike shpejt po le një emër,
Ndaj krenohet me ty fshati,
Hyso me të madhen zemër.*

*Homazh o Hyso Xhaferi,
O bir i nënës me derte,
Aq shumë këngën e deshe,
Edhe në këngë ti mbete.*

Vranisht, Labëri, 27 Mars 2022

NEXHIP ONJEA, POET



PSE U NXITOVE?!!!

*Bilbilat heshtën një çast,
pushuan këngën në pyje,
dolën nga foletë jashtë,
një shok përcollën në yje.*

*Nisën vajin, bashkë me ta,
ligjëroja edhe unë,
kjo mungesë, nuk është shaka,
nuk është as ëndërr në gjumë.*

*Pse vëlla, pse u nxitove,
"preve" në besë shoqërinë?
Përse këngën e pushove?
Helmve gjithë Labërinë.*

*Tani ëngjëll për të gjallë,
laj e krih shpirtin në qiell,
duku si pëllumb i bardhë,
eja dhe na ngroh si diell!*

"O MARGARITAR", NGA KRISTO ÇIPA



Në bardhësinë e kësaj bore dhe në pikëllimin e këtyre reve vetull puja shpirti i Hyso Xhaferaj mori udhëtimin fluturues atje ku shkojnë shpirtrat e fëldishtë. Na la pas mijëra tingëllima drithëruese dhe morri me vete para kohe dëshpërimet e familjes, miqve dhe artëdashësve. Këngën deshi në këngë shkoi. Kjo është përcjellja ime që kurrë nuk doja që ta sillte jeta.

O MARGARITAR!

*I drejtohem Zotit
Lutem pëshpërisht
Pikëllimin e lotit
Të na i kthejë në shpirt*

Hyson ta bëjë Krisht

*Një nga një me radhë
Si vet bilbilejtë
Shkuat këngë bardhë
Të "zaptoni" qiejtë*

Hyson shumë e deshtë

*S'prite borë e stinë
Që të nxirrim mallë
Dritë e fosforinës
O MARGARITARË!*

Kthehu! Ç'do në varrë!

*Kthehu bir i skenës
Bën belinë që deshe
Zërin e princshës
Mos e merr me vete
Na i ler peshqeshe*

Meramet e tua

*M'i ke thënë të gjitha
Hyso sa të dua
Le t'a dijë dita*

Ditë besë liga

*Në parajsë je hedhur
Ne në lumë të ferrit
Ëngjejt janë zverdhur
Për Hyso Xhaferin*

Të më puthësh Lefterin!

*O ju që na dogjët zëmërën
Ju lutem mos merrni këngën!*

VLERËSIME E KRIJIME LETRARE KUSHTUAR FIGURËS ARTISTIKE TË HYSO XHAFERAJ PËR NDARJEN E PARAKOHSHME NGA JETA

KOMENTE TË SHUMTA, VLERËSIME PAFUND PËR FIGURËN E HYSOS NGA FAMILJARËT, TË AFËRMIT, MIQTË E SHOKËT E TIJ TË SHUMTË, BASHKËFSHATARËT DHE KOLEGËT E PUNËS DHE ARTISTËT NË PËRGJITHËSI. KJO TREGON PËR SHPIRTIN E MADH NJERËZOR DHE ARTISTIK TË KËTJË NJERIU TË PAARRITSHËM ME ZËRIN E TIJ TË VEÇANTË E TË BUKUR. ËSHTË E PAMUNDUR T'I BOTOSH TË GJITHA, POR NJË PËRZGJEDHJE TË TYRE, MUND TI LEXONI MË POSHTË.



MIHAL KAÇI DHE SHOQATA ZAGORI, GJIROKASTËR, vlerësojnë lartë figurën e Hyso Xhaferaj, si një hedhës brilantë i këngës labe dhe si një mik i veçantë i Zagories, ashtu siç ishte mik i gjithë labërisë dhe jo vetëm. Ja si shprehen ata:

"Më 27 Shkurt 2022 pushoi së rrahuri zemra e Korifeut të Ansambli Shtetëror, hedhësit brilant të Polifonisë Labe, HYSO XHAFERAJ. Hysoja ishte një nga zërat brilant të rrallë që kishte lindur kjo tokë. Zëri i tij ishte dhuratë qiellore që ngjasonte me meloditë e ëngjëjve. Me hedhjen e tij ai "thyente qelqet e Qiellit", siç e përshkruante "Nderi i Kombit", Lefter Çipa. Hysua ishte një nga miqtë e ngushtë të Zagorisë. Ai e deshi shumë këtë krahinë dhe e vlerësonte për arsimin e kulturën, traditat dhe këngët e saj. HYSO

XHAFERAJ ishte nga ata gjeni që Zoti i deshi përvete pasi erdhi në këtë jetë dhe iku shpejt duke lënë një pasuri të madhe në breza. I shprehim ngushëllimet familjarëve të tij dhe gjithë të dashurve që ai la pas. I PAVDEKSHËM!

Ligjëron sot kënga labe,
Flamuri në gjuhë ka rënë,
Ku vajti Hyso Xhaferaj,
Shpirti që jeton në këngë.

Hyso pse ike nxituar,
Na dhe plagë në krahuar.

Vetëtimat çajnë retë,
Detet me valë trazuar,
Po rënkojmë me buzë plasur,
Për një yll të shënjtëruar.

Hyso krahët na i preve,
Pse kaq shpejt ti u rrëmbeve.

Malet pse i rrokullise,
Përmbi ne dhimbjen e derdhe,
Ti pranverë me lule shumë,
Ç'pate që shpirtin na there.

Perëndia s'i nxitoi,
Pse të thirri kaq shpejt pranë,

Për atë zë të florinjte,
Të këndosh lartë në Parajsë.

Po për ne ti nuk mendove,
Pse kaq shumë na varfërove.
Skenat në supe i ngrite,
Ëngjëll i Polifonisë,

Për këngën jetën e shkrive,
Nur simbol'i dhëmskurisë.
Ti mbete yll' i karvanit,
Ishe Ball' i shoqërisë,

Fjalë çelik e burrë vatani,
Hyso bir i Labërisë.

Fluturove pakuptuar,
Pikëllim i pambaruar.
Nëpër qiellin me yje,
Në çdo mbrëmje e mëngjes,

Do dëgjohet kënga jote,
E kënduar nga çdo brez.

Për ty çel lule Parajsa,
Atje të lundrosh i qetë,
Zëviolinë e Labërisë,
Atje lartë ku thyen qelqtë.

Atë zë kush ta dhuroi,
atë nur si vetë behari,
mos Bogonica të dërgoi
shikimin shqiptonjë mali?

Bilbilit do t'i thëras,
yjeve do t'u drejtohem,
edhe hënës lart mbi mal,
me Hyson që tëç'mallohem.

Hyso bilbil Kallarati,
këngën pse se përfundove,
zemra jote vallëç'pati,
pse kaq shumë na hidhërove?

Ngreu o Hyso Xhaferaj,
dhe fillo nga drithërimet,
si ujë gure këngët derdhi,
të nisin nga fluturimet.

Bir i Labërisë legjendë,
ti ngele një këmbë mali,
nektar i këngës në skenë,
për ty do na marrë malli.

**FESTIME VESHAJ (XHAFERAJ),
MOTRA**



Sot një muaj pa ty vëlla! Kjo datë e mallkuar që na nxiu shpirtin e na plagosi zemrat! Unë akoma se kam pranuar ikjen tënde dhe s'jam pajtuar me mungesën tënde! Ti do jesh i pavdekshëm si emrat që janë në atë lapidar!

Sot një muaj pa ty vëlla!

Sot një muaj je larguar nga kjo jetë.
Shpirti na është përveçuar më s'na flet.
Zërin më s'ta kam dëgjuar që vinte te ret'
Pres mëngjesin unë cdo ditë orën 9 pa 5
Pres që një zile të vijë po më kot që pres
Mos vallë rrugën ke marrë të dal të të pres.
Mëndja c'ka që më gënjen se më ti nuk vjen.
Bëmë ca plane për Pranverë më preve në besë.
Vall do mundem të besoj Por më kot.
S'ka dit' mos të ligjëroj e mbytur në lot.
Se ti ike shumë i ri brenga, pengje plot.
Ah mor Hyso kot e kam veten se mbaj dot.
Pse nuk erdhe si përherë, lule plot po na erdhe moj Pranverë, mbushur helm e lot!

NAZIF ÇELA, KËNGËTAR



Dedikim për mikun tim të shpirtit Hyso Xhaferaj. Qofsh i paharrur në mendje e zemrat tona.

Vëllai im Hyso Xhaferaj
Polifoni qemeri
Gjerdan me ngjyra ylberi
Na u trete si sheqeri

DAFINA XHAFERAJ, MOTRA:



O zot! Pse ma more vëllain e madh, vëllain e motrës së madhe? Në mendje më sillen kujtimet e tua. Të kam para syve edhe nuk shoh asgjë

tjetër. Më oshëtin në vesh zeri yt dhe më duket sikur më qetëson shpirtin, sikur më mbulon sërish me krahët e tu. Mendoj sikur papritur do të takoj, këtu në Vlorën tënde, aty ku u linde dhe u rrite bashkë me talentin tënd të rrallë, ku vëllait dhe motrave u le krenarinë, fisnikerinë, bashkë me zërin tënd hyjnor. Kur t'ia marrim këngës, edhe ajo të vejë po njësoj, se do të jemi sërish të katër të pandare si më parë. O artist i madh, artist i skalitur në yjet e kombit tënd, ishe alegria dhe gazi i çdo tavoline që ne shtronim. Po ashtu, nëçdo gëzim e dasma, ti ishe aty me ne, dhe do të mbetesh si imazh në mesin tonë, ashtu i pandarë, imazh gjithëmonë i qeshur, e dredhur zërin tënd për "Këngën e nënës" e "Vajzën e valëve"!

FESTIME VESHAJ (XHAFERAJ), MOTRA

Çfarë ka syri që loton po kjo zemër pse u ça?
Për vëllanë shpirti vajton,
se na u këput njëri krah.

Katër ishim, dy e dy sa të lumtur neve qemë po zoti pse të mori ty?
gaz e këngë ne e premë!

Për vëllanë buza s'qeshet shpirti bërë thërrime e copë lutem çdo ditë, ai s'kthehet çfarë mban, pse s'çahesh tokë?

Çohu nise këngën prapë, se ke shumë për të bërë Thoshe i lashë në baltë të pret shoqëri e tërë!

Jo, s'pronoj që ti ke vdekur je i gjallë e me të gjallët rron ti majat e suksesit ke prekur dhe në zërat e bilbilave të malit jeton!

Hyso trëndafil i majit
Vëlla e shkuar vëllait
Lashë këngën ia nisa vajit
Pasha shkuar Pashait

Ligjëroi lëmin e fatit
Hyso Bilil gojëmjalti
Gjuhë bilbil i Kallarati
Shkoi pranë Lefter namlartit

O fosforin Labërie
Spiralepolifonie
Prehu në qiell përjetësie
Aty losë e qesh me yje

POLO ÇIPA, POET



Ç'qe ky lajm i zi që erdhi,
edhe mali gjëmoi rëndë,
paska vdekë Hyso Xhaferaj,
në parajsë shkoi për këngë.

Mos bilbil, pse kaq nxituar,
rrugë e gjatë dhe pa kthim,
na le syrin të lotuar,
na le këngën në lotim.

VLERËSIME E KRIJIME LETRARE KUSHTUAR FIGURËS ARTISTIKE TË HYSO XHAFERAJ PËR NDARJEN E PARAKOHSHME NGA JETA

KOMENTE TË SHUMTA, VLERËSIME PAFUND PËR FIGURËN E HYSOS NGA FAMILJARËT, TË AFËRMIT, MIQTË E SHOKËT E TIJ TË SHUMTË, BASHKËFSHATARËT DHE KOLEGËT E PUNËS DHE ARTISTËT NË PËRGJITHËSI. KJO TREGON PËR SHPIRTIN E MADH NJERËZOR DHE ARTISTIK TË KËTJË NJERIU TË PAARRITSHËM ME ZËRIN E TIJ TË VEÇANTË E TË BUKUR. ËSHTË E PAMUNDUR T'Ë BOTOSH TË GJITHA, POR NJË PËRZGJEDHJE TË TYRE, MUND T'Ë LEXONI MË POSHTË.

FESTIME VESHJAJ (XHAFERAJ), motra duke vajtuar për vëllanë me ligje.



U prehsh ne paqe bilbili i motrës

Shkurti në të shkuar
shumë na ke helmuar.
Dita në të zbardhur
Hyson na ke marrur.
Për ty gjysmë jete
trimi që nuk jepe
shpirti që nuk trete
o vala mbi dete.
Hyso o vëlla
na bere hata
helmove dynjanë
mbas e le babanë.
Shkove lart në yje
të ndrisësh mes tyre.
Çohu nise këngën
zbukuroje Hënën
takoje dhe nënën.
Bilbil të ka motra
si do të mbaj toka?
O bilbil qyzar
këndo si më parë.
Hajde në trapeze
me alegri ndeze.
Hyso kudo ishe
sa lezet që kisha
më në fund e prishe
more rrugën ike.
Shkove në parajsë
shumë gjëra le pas.
Ike pa kuptuar
more zë pruar.
Këndo si mëparë
Hyso o zelarë
malli do na marrë
më s'kemi vëllanë!

POEZI, NGA JETA FEJZAJ



Lamtumirë Hyso Xhaferi
Humbja jote zëmra theri
Zëmrat që i dogje flakë
Si të durojë babai plak

Po motrat si të durojnë
Luten për ty dhe vajtojnë
Vëllait i është këputur shpirti
Rrugë të gjatë Hysua nisi

Familjes u iku dielli
Gri e zi u bë dhe qielli
Shtëpisë e iku kënga
Vaj e helm pikojnë shumë zëmra


Zot pse s'pate pak mëshirë
Dritë e tija pse u sos
Atë nurë e atë këngë
Qysh rri rënë ai kollos

Atë zë e atë pamje
Si e trete thellë në dhe
Do mungoj në isot labe
Kollosi i skenave

Hysua do jetojë në këngë
Penat do shkruajnë për të
Por bilbilat që u ngjante
Do vajtojnë e qajnë nën zë

Lamtumirë Hyso bilbili
Nuri edhe bukurija
Sot për ty qanë dhe guri
Shqipëria labëria

Lamtirë vëllai ynë
Trupi jot u Prehtë në Paqe
Se shpirti i duhet këngës
Skenave kalasë me harqe



ALKIDA SHYTAJ, MBESA: Eshte pothuajse e pamundur, në këtë ditë të ngrohtë, me qiell të hapur, ku nëpër ajër ndihen aroma të ngatërrueshme lulesh, në këtë fillim Praneverë, të mendoj qëti, dajua im, nuk je!

Nuk je, edhe zhurma lebetitese e kesaj fjalie me lekund me force, zbrazetia qe ke lene, m'i zhvesh pemet e mbushura me sythe, me rrezon gjethet e sapocelura...

Ti nuk je më këtu, edhe kjo mosqënie fizike, më bën të ndiej dimër, një dimër të akullt ku na ke lënë të gjithëve!

Unë i them gjyshit, (Balilit) që nuk mund të ndryshojmë dot asgjë që i përket fatit, që ka një arsye të pakuptueshme për botën njerëzore, por shumë të qartë për botën tjetër... Dhe Ai pohon. Pranon. Rënkton. Mendon. Forca e tij është mahnitëse, mbulon me fisnikëri gjithë dhimbjen e tij, që asnjë fjali e shkruar bukur edhe plot krahasime, nuk mund ta shprehë....

Dajo, Ti na ke lënë shumë kujtime, aq shumë sa lenë vetëm njerëzit e rrallë, artistët e pajisur me talent hyjnor, ata të cilët nuk bëjnë asgjë të imponuar, por zenë vend në zemrat e të gjithëve! Je me ne gjithmonë, derisa të takohemi sërish!

SEJMEN GJOKOLI, GAZETAR



PUSHOI KËNGËN BILBILI. - në vend të homazhit për këngëtarin lab të Ansambllit të Këngëve e Valleve Popullore, Hyso Xhaferaj-

Pushoi këngën Bilbili,
Hyso Xhaferaj, si ylli.

Hyso këngën pse pushove,
Pse kaq shumë na helmmove?

Kallarati të kish djalë,
Labëria këng' në ballë.

Ike të ndriçosh me yje,
Mbetë këngësh, Labëria.

I përjetshëm kujtimi yt, Hyso i
shtrenjtë!

VEFI XHAFERAJ, KUSHËRIRA



Kaluan plot tre javë,
Ku ngele pse s'ke ardhë?
Të presin djemtë në shkallë
Të presim të gjithë me radhë
Ku ngele bilbil i rrallë?
Që e more botën mbarë
Të thanë shokët "Margaritar",
O Perlë e Laberisë së madhe,
Perlë e PolifonisëLabe
Që le gjurmë madhështie
Këngë e valle shpirt bukurie.
O margaritar, o dritë
Pse vendose mos të vish???
Pse do na i thash sytë????
Yjet s'janë për në tokë
Fluturojnë nga kjo botë!

U prehsh në paqe, o vëllai im,
Hyso Xhaferaj!



AJO KËNGË QË S'U KËNDUA, NGA EVGJËNI JONUZAJ

Nga këngëtarja kallaratase, Evgjëni Jonuzaj, dedikuar me dhimbje e lot, bashkëfshtarit, bashkëmohatarit, kolegut të saj, Hyso XHAFERAJ.

Para pak pandemisë në një bisedë me Hyson - shkruan Evgjënia - menduam të realizonim disa këngë me grupin polifonik të fshatit, duke përfshirë të gjithë brezat edhe një elegji me Hyson, Zeqon dhe unë. Por nuk qe e thënë, se ti ike para kohe, ike pa na lajmëruar. Ike atje lart në qiell, ku ti nuk duhej të ikje. Ike dhe na le të shtangur. Të jap fjalën që ne do ta realizojmë, sepse zërin tënd e kemi këtu midis nesh, zërin nuk e more me vete, na e le si kujtim për gjithë jetën.

U rritëm bashkë, kënduam bashkë. Hyso ti ike dhe na le të qajmë vetëm, të qajmë për ty.

U këput një këmbë mali,
Kallarati të iku djali,
Të iku bilbili i këngës
Shkoi në gjirin e nënës
Iku Hyso këngëtar
Zëri si bilbil gjyzari,
Iku Hyso bukuria,
Djali që kish Labëria.
Iku Hyso Kallarati,
Ashtu qe i shkruar fati.
La në mes këngën me mua
Ajo këngë që s'u këndua ...

I përjetshëm në kujtimet tona, o Hyso!

VLERËSIME E KRIJIME LETRARE KUSHTUAR FIGURËS ARTISTIKE TË HYSO XHAFERAJ PËR NDARJEN E PARAKOHSHME NGA JETA

KOMENTE TË SHUMTA, VLERËSIME PAFUND PËR FIGURËN E HYSOS NGA FAMILJARËT, TË AFËRMIT, MIQTË E SHOKËT E TIJ TË SHUMTË, BASHKËFSHATARËT DHE KOLEGËT E PUNËS DHE ARTISTËT NË PËRGJITHËSI. KJO TREGON PËR SHPIRTIN E MADH NJERËZOR DHE ARTISTIK TË KËTIJ NJERIU TË PAARRITSHËM ME ZËRIN E TIJ TË VEÇANTË E TË BUKUR. ËSHTË E PAMUNDUR T'I BOTOSH TË GJITHA, POR NJË PËRZGJEDHJE TË TYRE, MUND TI LEXONI MË POSHTË.

RIZA MEMUSHAJ



HYSO BALIL XHAFERAJ

Ishe bilbili vet
Labçes me grykë ja thojë
Këngës i jepje lezet
Kënaqësi të të dëgjoje

Me zërin si violinë
Lloj lloj tingulli prodhoje
Ja ktheje me ulurimë
Zemrën ta dridhëroje

Ishe mjeshtër i vërtetë
Ndaj dhe Ansambli Shtetëror
Të mori në gji të vet
Ti e bëre më cilësor

Ëmbëlsia e zërit tënd
Çau gryka, çau male
U ndje në çdo vënd
Në koncerte, festivale

Kthyes dhe hedhës magjik
Kështu të patën cilësuar
Me bilbilat ishe mik
Në mes tyre ke jetuar

Zëri jot kë nuk kënaqi
Këndove me Hysni Zelën
Edhe me zonjën Qiriako
Edhe bashkë me Nazif Çelën

Labçes do i mungojë
hedhsi i saj më i shquar
Por kënga s' do të ndalojë
E zëri yt s' ka për t' u shuar

SEIT JONUZAJ, VETERAN



HYSO GJUHË BILBILI

U shkëpute si yll nga qielli,
U helmua jo vetëm Balili,
Kallarati e Labëria
Po e tërë Shqipëria.

Kishe vlera bukurie
Me zë bilbili polifonie,
Artist me ndjenja krenarie,
Me shpirt e vrull epërsie.

Vite e shekuj do kalojnë
Këngët e tua do jehojnë,
Zëri e melodia do tingëllojnë,
Njerëzit kurrë s' do të harrojnë.

FOTIS HABILAJ

(këtë poezi ia kushtoj gjitonit tim
Hyso xhaferaj)



Shkurti në të dalë
Datë njëzet e shtatë
Një zemër birbili
Pushoi në Kallarati

O Hyso Xhaferaj
Birbili këngës labe
Në moshën më të bukur
Ti përse u ndale

Lajmi është i rëndë
Dhimbja është e madhe
Për djalin e fshatit
Birbili i këngës labe

O Hyso xhaferi
Ike fizikisht
Zëri jotë i ëmbël
Do dëgjohet përjetësisht

VASIL LAPA, POET



Ç' pati dielli përse u shua.
Retë zunë me bubullimë.
Zunë malet e vajtojnë.
Zia mbuloi labërinë.

Labëri me shumë halle
Valle kë përcjell me lot.
Artisti me shume nure.
Vallë pse s' është me shokë .

Hyso Xhaferi bukuria.
Me atë sy si shqiponjë.
Si na ike pa Kultur.
O i zgjedhuri me dorë

Pse të bëri kaq të mirë.
Ajo nënë dërguar në paqe.
Të helmoje shoqërinë
Na ngrive lotin në faqen.

Do t'iu lutem dhe njëherë.
Jo vaj për Hyso Xhaferë.
Po ta gdhendim në këngë .
Buzëgaz dhe hije rëndë.

Ligjërimet jo s' pushojnë.
Si bora mbi Bogonicë.
I pa vdekshëm Hyso Xhaferi.
I gjallë sa mali në këmbë

TOMORR LELO, KËNGËTAR



Hysua me shpirtin flori
Me buzëqeshjen farfuri.
Nxitoi për në përjetësi
Atje te idhujt e ti
Në krah të tyre të rri.
Ne na la me lotë në sy...

YLLKA SERAJ, KUNATA



Ti Hyso zemër flori
Pse na ike kaq i ri
Pse s' mendove për fëmijë
E për gruan që e le
Vedova kaq të re
Sa shumë u mundove ti
Të krijoje një shtëpi
Me djersë e me mundime
Me këngët që këndoje
Të gjithë ti i shokoje
Me zërin si bilbil mali
O sa shumë do na marr malli
Hyso ti shumë nuk mendove
Se vdekjen ti se pranoje
Se ishe djali i ri
E gjysh do të bëheshe ti
Mesi prisje ti shikoje
Dhe në prehrë ti mbaje pak
Se për ta kishe merak
Se Alvaro është shumë i ri
Po u bë me tre fëmijë
Zoti t'ju jap mbarësi
Ti Hyso rri i qet
Se ata do të gëzojnë
Mjer për jetën që s' të la
Që ti ta shijojë pak
Se zoti të deshi lartë
Të të bej engjëll për ne
Për të ruajtur përmbi re
Na shiko me sytë e tu
Ne zërin do ta dëgjojmë
Dhe për ty do të përgjërohemi
Në paqe të gjesh qetësi
Se ti je shumë i ri

VLERËSIME E KRIJIME LETRARE KUSHTUAR FIGURËS ARTISTIKE TË HYSO XHAFERAJ PËR NDARJEN E PARAKOHSHME NGA JETA

KOMENTE TË SHUMTA, VLERËSIME PAFUND PËR FIGURËN E HYSOS NGA FAMILJARËT, TË AFËRMIT, MIQTË E SHOKËT E TIJ TË SHUMTË, BASHKËFSHATARËT DHE KOLEGËT E PUNËS DHE ARTISTËT NË PËRGJITHËSI. KJO TREGON PËR SHPIRTIN E MADH NJERËZOR DHE ARTISTIK TË KËTJ NJERIU TË PAARRITSHËM ME ZËRIN E TIJ TË VEÇANTË E TË BUKUR. ËSHTË E PAMUNDUR T'I BOTOSH TË GJITHA, POR NJË PËRZGJEDHJE TË TYRE, MUND TI LEXONI MË POSHTË.

ZËRI QIELLOR I HYSO XHAFERAJT, NGA GAZETARI ALEKSNDËR ÇIPA



Në fakt ai është zëri njerëzor që shpërbën distancat dhe dimensionet e hapësirës. Versioni më autentik i "Enigmës" shqiptare. Zëri i filltë i Hysos është i vetmi, ndoshta si i askujt tjetër që të shkakton si ndiesi dhe perceptim, me çdo korde dhe tingull të tij, asosacionin e përkryer të hapësirës dhe tejhapësirës. Ndiqeni në këtë interpretim përbashkues me virtuozen Irini Qirjako dhe pasueshëm me divën Aurela Gaçe, se çfarë magjie përfaqëson ky zë. Hyso Xhaferaj është (them është, sepse ai gjendet në amëshim, por zëri ka mbetur për një udhëtim të pakohë mes jetës njerëzore), një interpret profesionist i tingujve dhe semantikës tingullore.

Do të duhej me kohë të ndalej kushdo prej studiuesve të etnomuzikës dhe muzikologjisë tek ky zë, tek fenomeni vokal dhe interpretativ i një këngëtarit kaq unik, i një interpretuesi aq të hollë dhe me finesën magjike që tejkalon shamin interpretativ të çdo zonje arti, që sfidon instrumentet, kryesisht violinën dhe që magjishëm të jep elementët e mistikës njerëzore, kryesisht asaj të shpirtit që mund të gjenerojë si asosacion zëri unik. Tek kordat dhe zgjatimet vokale të zërit të Hyso Xhaferajt, talente të ndërprera si Doktor Flori i West Side Family, gjetën pikërisht atë rrallësi dhe rubin vokal me të cilin krijuan brilantet muzikore të repertorit të tyre.



Në këtë unikalitet Hyso Xhaferaj është i vetmi këngëtar shqiptar madje pse jo edhe i përbotshëm, që nuk la asnjë këngë të plotë si repertor të vetin, por krijoi unikalitet versionin e një këngëtarit që shkëlqeu dhe do të shkëlqejë në tejkohësi përmes kryeveprës së introduksioneve vokale të vetvetes. Fatkeqësisht, ai kishte në përpunim rreth gjashtë këngë vetiake që do të formësonin të vetmin repertor unik dhe melodik, i cili për shkak të ikjes së parakohshme në amëshim, nuk u regjistrua dhe humbi në eternitet. Por shkëlqimi dhe rrallësia vokale e tij është shpërndarë dhe do të mbetet e pabjershme, herë si introduksion tek grupi i famshëm West Side Family, tek Aurela apo Irini, duke na e bërë përjetësinë e tij imponuese dhe mallëngjyese jo me këngë të plota, por me tinguj prej nje zeri që tejkalojnë e mbijetojnë si e plote e mbi çdo të plote vepër artistike. Ai është i përjetshëm me fragmente vokale, kur rëndom të përjetshmit kanë këngë të plota.

I përjetshëm edhe në zërin tënd vëllai im, tashmë i amëshimtë!



HYSO XHAFERAJ, "BILBILI ME ZË TE RRALLE", NGA SHKËLQIM KELO, KORÇË

I trishtë, i dhimbshëm e i hidhur lajmi i ikjes nga kjo botë në këtë 27 shkurt të vitit 2022 të solistit të shkëlqyer të Ansambllit Shtetëror të Këngëve e Valleve Popullore, Hyso Xhaferaj.

"Përse rri heshtur me pamjen e një zarfi pa adresë sipër" - ka thënë Mark Tueni. Dhe ne, familja, babai, vëllai, motrat, bashkëshortja, djemtë, miqtë e shokët e Hyso Xhaferajshim të tillë. Vdiq Hyso Xhaferaj - u hap lajmi si vetëtim, në mëngjesin e ftohtë të datës 27 shkurt. Megjithatë ishim

në dijeni të një sëmundje të pashërueshme, përseri nuk donim të besonim lajmin, kobëzi. Shpresonim, besonim në zot e mjekësi, në një mrekulli. Por..... nuk ishte e thënë. Atë ditë dëgjohej vetëm një zë, ai i qyqes, që ndillte kob. Të tjerët vajtonin në heshtje, e të tjerë me kuje. Dhe kishin të drejtë. U largua zëri brilant i polifonisë labe, bilbili i saj, Hyso Xhaferaj. Hysoja ishte i dashur, ishte i ëmbël, ishte i drejtë, ishte gojë mjaltë, ishte fisnik, ishte i çiltër, ishte bashkëshort, vëllai dhe prind i vërtetë. Hyso, ti të pushtojte me mirësinë e çiltërsinë tënde dhe ndizte tek çdokush motorët e respektit dhe dashurisë.



Vdekja nuk është, "sot je e nesër s'je, por sot je dhe sot s'je!". Kaq e shpejtë, kaq e beftë! Vdekja nuk ka as moshë e as kriter, kjo dihet tashmë. Por nuk e kuptoj, pse përzgjedh të na lëndojë, aty ku dhembja na përshkon tejprtej?

Ti duhet të ishe i mbuluar vetëm me dashuri, ëmbëlsi, gaz e hare, ngjyra, muzikë e ar të pruar! Dhe kështu je!



Të kanë mbuluar fjalët e lotët e ndjera, të ëmbla e të nderuara të gjithë atyre që të kanë njohur apo dëgjuar emrin!

Vdekja e një miku është një dhëmbje e madhe për ta duruar. Nuk janë vitet që të bëjnë mik me një njeri se kjo pak rëndësi ka, por janë vlerat dhe vrytytet që të bashkojnë. Pikërisht se tek Hysua ishin kultivuar dhe mëshiruar tiparet e një njeriu të mirësi, kurajua dhe këmbengulja, entuziazmi dhe forca, grinta dhe alegria, bujaria dhe altruizmi.

Të kisha mik si dhëndër Kallarati

që jam e të krushqisë që na lidh me Xhaferajt, por më shumë shok. Nuk kam për t'i haruar kurrë takimet me Andonin, Lefterin, Bardhin, Andrean, Nazifin, Muntazin, Nikun e shumë e shumë të tjerë, në raste ditëlindjesh, por më shumë në takime spontane që lindin nga një telefonatë. Kurrë nuk the jo. Nuk e njihje këtë fjalë. Më prisni se erdha, ishte në çdo rast përgjigjja jote.

Edhe ato vargje të pakta të këngëve labe që kam mësuar, i kam falë teje, që këmbëngulje që edhe të mesoja të kendoja pak labçe, si dhëndër Labërije. Dhe kur gaboja (dhe kjo ndodhte shpesh), ti me zërin tënd brilant, mbuloje gabimet e mia.

Nuk mund të harrojmë buzëqeshjen tënde ku transmetoje, mirësi, ngrohtësi dhe dashuri. Në aspektin personal, Hysua ishte një burrë korrekt dhe i përgjegjshëm, një baba i respektuar. Ishte një njeri pa vese dhe gjithmonë besnik i të drejtës dhe i të vërtetës.



Shoku dhe miku ynë Hyso! Sa shumë të deshi familja jote, sa shumë të deshën miqtë dhe shoqëria, por më shumë të paska dashur Zoti, që të ndahu nga të gjithë dhe të mori me vehte. Ti meriton parajsën që zoti do e ketë rezervuar për ty. Dheu qoftë i lehtë për ty shoku dhe miku ynë! Familjes tënde zoti t'i falë durim! Ti u largove, por do mbetesh i gjallë dhe prezent në çdo zemër të miqëve dhe dashamirësve të tu.

Artistë të mëdhenj ky vend ka nxjerrë e do të nxjerrë prapë. Por njerëzit si ti i ka gjithmonë e më të rrallë.

Kurrë nuk e mendonim se do të

mposhte vdekja. Njeri model, i dashur, i qeshur përherë, zemërbardhë dhe i gjerë, në kujtesën e gjithënjëzëve. Vuajte dhe nuk hoqe dorë kurrë nga dashuria për jetën. Ti ishe një njeri që shumë e admiroje dhe respektoje jetën. Plot pesë ditë që e filloj dhe e mbyll ditën duke dëgjuar këngët e kënduara nga bilbili Hyso.

Gjithë shpirtat e njerëzve janë të pavdekshëm, por shpirtat e të drejtëve janë të pavdekshëm, edhe hyjnorë, - ka thënë Sokrati.

VLERËSIME E KRIJIME LETRARE KUSHTUAR FIGURËS ARTISTIKE TË HYSO XHAFERAJ PËR NDARJEN E PARAKOHSHME NGA JETA

KOMENTE TË SHUMTA, VLERËSIME PAFUND PËR FIGURËN E HYSOS NGA FAMILJARËT, TË AFËRMIT, MIQTË E SHOKËT E TIJ TË SHUMTË, BASHKËFSHATARËT DHE KOLEGËT E PUNËS DHE ARTISTËT NË PËRGJITHËSI. KJO TREGON PËR SHPIRTIN E MADH NJERËZOR DHE ARTISTIK TË KËTJË NJERIU TË PAARRITSHËM ME ZËRIN E TIJ TË VEÇANTË E TË BUKUR. ËSHTË E PAMUNDUR T'I BOTOSH TË GJITHA, POR NJË PËRZGJEDHJE TË TYRE, MUND T'I LEXONI MË POSHTË.



NJË FALENDERIM NGA FAMILJA XHAFERAJ.

Bako Xhaferaj, vëllai i Hysos, në emër të gjithë familjes Xhaferaj, falenderon me radhë të gjithë të afërmit, miqtë, shokët e familjes dhe gjithë miqtë, shokët, kolegët, artistët e këngës e muzikës të Ansambllit të Këngëve dhe Valleve Popullore dhe të grupeve të ndryshme me të cilët Hysua bashkëpunoi dhe këndoi me gjithë shpirt e zemër, duke shpalosur talentin dhe zërin e tij të veçantë, të cilët në këtë moment të vështirë iu gjendën pranë familjes. Ja si shprehet Bakua:

"Faleminderit të gjithëve për mesazhet dhe telefonatat ngushëlluese që u bëtë pjesë në hidhërimin e familjes XHAFERAJ për humbjen e babait, bashkeshortit, vëllait, dajos, xhaxhait shëmbullor dhe artistin Hyso Xhaferaj. Dua të nis falenderimet për kolegët e Ansambllit të Këngës dhe Valleve Popullore me drejtues Z. Sokol Marsi, të cilët e vlerësuan figurën e vëllait tonë ashtu si ai e meritonte.



Falenderoj në mënyrë të veçantë kolegun dhe mikun e tij të ngushtë, i cili tani është edhe i familjes tonë. Lek Pecnikaj.

Falenderimet shkojnë për gjithë shokët e vëllait që iu gjendën pranë si: Panua, Nazifi, Nexhipi, Trifoni, Irfani, Andoni, Parua, Goligu dhe shumë të tjerë, të cilët s'mund t'i përmend të gjithë.

Falenderimi shkon edhe për mjeshttrat Hysni Zela dhe Irini Qirjako, të cilët do t'i quaj si kumbar të karrierës brilante të vëllait tonë.

Falenderimi shkon për familjen e të madhit Lefter Çipa "Nderi i Kombit", i

cili e konsideronte Hyson si djalin e tij të madh.



Falenderoj poetët, Kristo dhe Polo Çipa, Vasil Lapa, Nexhip Onjea, rapsodin Muhamet Tratar "Mjeshtëri i Madh", gazetarin Sejmen Gjokoli, këngëtarin kallaratase Evgjëni Jonuzaj, të cilët e shprehën dhimbjen e tyre me vargje, pa harruar edhe Katinën, Elenin, Monën, etj.

Faleminderit të gjithë bashkëfshtarëve kallaratase kudo që ndodhen pa përjashtim, që na u gjendën pranë në dhimbjen tonë e sidomos me komentet ngushëlluese në rrjetet sociale krijimet e tyre.



Faleminderit kushdo i njohur e panjohur që në rrjetet sociale kanë bërë vlerësime dhe shprehur ngushëllimet për Hyson.

Falenderoj të gjitha shoqatat e Labërisë si dhe miqtë shpirtëror dhe dashamirës të artit, që u bënë pjesë me statuset dhe vargjet e ndiera për Hyson dhe shoqatën "Kallaratit", në veçanti Z. Besnik Gjonbrataj, i cili ka qenë dhe është promovuesi më i mirë i vlerave të bijve të Kallaratit, siç është edhe vëllai ynë Hysua.

Falenderoj gjithë miqtë, të afërm, koleg të mitë dhe dashamirës pa përjashtim

që na u gjendën pranë. Falenderoj bashkeshortin e tij Meritën dhe djemtë Fatjonin dhe Alvaron, të cilët me kurajo të fortë iu përgjigjen me dinjitet humbjes së rëndë që u ndodhi. Falenderimi i fundit shkon për babain tonë Balil Xhaferaj, i cili edhe pse u plagos rëndë, me kurajo të pashembullt si një burrë i rrallë labërie pret dhe përcjell për djalin. Faleminderit edhe njëherë të gjithëve që u bëtë pjesë e dhimbjes tonë dhe ju uroj vetëm shëndet dhe mbarësi në familjet Tuaja. **FALEMINDERIT!**

Z. HYSO XHAFERAJ, PERSONALITET I SHQUAR I LABËRISË



Në një atmosferë dhimbjeje e krenarie njëherazi, në përkujtimoren e të 40-tave të Hyso Xhaferaj, në kryeqytet u zhvillua një aktivitet dinjitoz, i programuar si pak të tjerë deri më sot. Nismëtar dhe sponsor i këtij takimi, ishte burri fisnik nga Fushëbardha Nexhip Onjea.

... "Hyso Xhaferajla boshllëk të madh e të pazëvendësueshëm dot, për mijëra njerëz, në të gjithë trojet shqiptare.

Sepse njerëzimi, ka një Bankë të pashpallur, të vetmen Bankë të Shenjtë që ekziston. Njerëzimi sot, ka një Bursë, të pa ngjashme me asnjë Bursë tjetër.

Bursën e vlerave njerëzore, e

Bankën e gjurmëve që lenë njerëzit në jetë. Në këtë Bursë, duhet të jenë aksionerë të gjithë njerëzit.

Hyso Xhaferaj arriti të jetë aksioner i madh, i vlerave shumë të mëdha, si pak të tjerë, tha ndër të tjera në Fjalën e rastit, gazetari Pano Hallko.

Më pas përshëndetën me radhë miq, shok e koleg, si këngëtarja e njohur, Irini Qirjako "Mjeshtëri i Madh," zoti Sokol Marsi, Drejtor i Ansambllit të Këngëve dhe Valleve Popullore, zoti Andon Pango, kryetar i Shoqatës Zagoria, zoti Ervin Bejleri, aktor dhe i afërm i Hysos. Në vijim nga aktori Bujar Asqeriu "Nderi i Kombit" u interpretua elegjia me tekst të Nexhip Onjea "Ti do të rrosh sa të rrojë kënga". Gjithashtu ukëndua nga Nazif Çela e grupi kënga labe kushtuar Hyso Xhaferaj me tekst të Nexhip Onjesë.

Në fund të aktivitetit, Kryetari i Shoqatës "Labëria" zoti Ago Nezha i dorëzoi familjes Dekoraten "Personalitet i Shquar i Labërisë", akorduar Hyso Xhaferaj me këtë motivacion: "Për kontribut të dukshëm dhe të spikatur në trashëgiminë folklorike të Labërisë, interpretues virtuoz i këngës labe shqiptare në skenat kombëtare e ndërkombëtare, për talent kombëtar me kontribute magjike individuale, për vleranjohtëse dhe hedhës brilant i këngës labërishte, mjeshtër i pakrahasueshëm në këngë si hedhës, marrës e kthes, gjuhëbilbili i Kallaratit të Vlorës"

Në emër të shoqatës Kallaratit, zoti Besnik Gjonbrataj, falënderoi organizatorët për aktivitetin e zhvilluar për birin e Kallaratit, "Bilbilin e Labërisë", Hyso Xhaferaj.

Në emër të familjes falenderoi organizatorët dhe të gjithë pjesëmarrësit, vëllai i Hysos, Bako Xhaferaj, i cili midis të tjerash theksoi: "Hysua nuk ishte vetëm biri dhe vëllai jonë, por miku dhe vëllai i të gjithë Juve të pranishëm në këtë aktivitet, por edhe shumë më tepër, prandaj ai me të vërtetë do të rrojë sa të rrojëvetë kënga labe, së cilës iu përkushtua gjithë jetën". **Faleminderit.**

Qoftë i paharruar kujtimi i djalit të Kallaratit, "Bilbilin të Labërisë", HYSO XHAFERAJ!

Redaksia e gazetës: Kryeredaktor: Seit Jonuzaj;
Redaktorë: Hiqmet Meçaj; Çize Xhaferaj; Lefter Hysaj; Rami Memushaj; Besnik Gjonbrataj.
Arti grafik: Andi Meçaj.
www.kallarati.com; e-mail: gazetakallarati@yahoo.it